



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.31

2004

21 maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4217 datë 3.5.2004	Për emërimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.....	2539
Vendim i KM nr.292, datë 7.5.2004	Për miratimin e strategjisë kombëtare antidrogë 2004-2010....	2539
Vendim i KM nr.294, datë 14.5.2004	Për lejimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" për prodhimin e mjeteve lëvizëse për invalidë	2551
Vendim i KM nr.295, datë 14.5.2004	Për caktimin e selive dhe të rezidencave, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë	2552
Vendim i KM nr.296, datë 14.5.2004	Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza"	2553
Vendim i KM nr.298, datë 14.5.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.20.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	2555

Vendim i KM nr.299, datë 14.5.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.281, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë".....	2555
Vendim i GJL nr.1, datë 16.4.2004	Me objekt kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion, parashikuar në nenin 114/b/2 të Kodit Penal.	2556
Vendim i GJL nr.10, datë 24.3.2004	Me objekt përmbushjen e detyrimeve kontraktore, në bazë të kontratës së datës 13.1.2003.....	2564
	Shpallje shtesë kërkesë shpronësimi me objekt shpronësimin që prek ndërtimi i segmentit rrugor Balldre-Piraj, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër.....	2570
	Shpallje shtesë kërkesë shpronësimi me objekt shpronësimin që prek ndërtimi i segmentit rrugor Piraj-Kthesa Vau i Dejës, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër.....	2572

DEKRET
Nr.4217, datë 3.5.2004

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 125 pika 4 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Z. Gjergj Sauli emërohet Kryetar i Gjatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.292, datë 7.5.2004

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE ANTIDROGË 2004-2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare antidrogë 2004-2010, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen institucionet përkatëse për zbatimin e kësaj strategjie.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
STRATEGJIA KOMBËTARE ANTIDROGË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 2004-2010

1. PARATHËNIE

Strategjia e luftës kundër drogave e Republikës së Shqipërisë është hartuar me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe lokal të përfshira në luftën ndaj këtij fenomeni, si dhe të organizatave joqeveritare të mbështetura nga ekspertë të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e luftës kundër drogave është një manifestim i angazhimit të Qeverisë shqiptare për të luftuar këtë fenomen, si dhe për t'u asistuar individëve apo grupe individësh të prekur nga shpërndarja ilegale e drogave.

Kjo strategji e njeh dhe e pranon natyrën serioze të problemit si në nivelin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Gjithashtu kjo strategji pranon faktin se në luftën kundër drogave mund të jemi të suksesshëm vetëm nëse koordinojmë përpjekjet tona, ato të qeverisë, të shoqërisë civile dhe të partnerëve ndërkombëtarë.

Besojmë se përpjekjet tona do të kontribuojnë për të vënë nën kontroll efektet e drogës ndaj komunitetit dhe se vendi ynë do të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet ndërkombëtare për të luftuar drogat.

2. METODOLOGJIA

Strategjia është strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikojë qartë qëllimet dhe objektivat.

Në hartimin e kësaj strategjie është analizuar dhe referuar eksperiencia e vendeve të tjera europiane, si dhe nevoja që shteti, institucionet kombëtare dhe lokale, OJF-të, media dhe komuniteti i gjerë duhet të angazhohen në zgjidhjen e problemit të luftës kundër drogave dhe abuzimit me to në Shqipëri.

Droga nuk mund të luftohet vetëm nëse do të konsiderohet përgjegjësi e një institucioni.

Duke angazhuar përpjekjet e veçanta në nivel kombëtar dhe lokal, ne po kontribuojmë në transformimin e përpjekjeve të izoluara të institucioneve të veçanta në një përpjekje kolektive në të mirë të vendit dhe të luftës ndërkombëtare kundër drogave dhe krimit të organizuar në përgjithësi.

Jemi të ndërgjegjshëm se do të duhet kohë të arrijmë qëllimin tonë kryesor. Por kjo strategji paraqet mirëkuptimin tonë dhe është hapi i parë në arritjen e prioritetëve strategjike. Prandaj, me strategjinë tonë të parë antidrogë ne kemi përcaktuar kuadrin e veprimeve tona për gjashtë vitet e ardhshme. Kjo strategji nënkupton rinovim të strukturave për të arritur objektivat e përcaktuara dhe do të pasohet nga një plan veprimi i detajuar.

Strategjia është fillimi i një tranzicioni të vështirë, por tejet i rëndësishëm, ku përpjekjet e përbashkëta të ministrive dhe agjencive të veçanta do të transformohen në një ndërveprim strategjik.

Shtyllat kryesore mbi të cilat është mbështetur kjo strategji janë katër:

1. Politika e balancuar në fushën e drogës;
2. Koordinimi strategjik;
3. Shkëmbimi i informacionit;
4. Shpërndarja e shërbimeve në funksion të uljes së kërkesës.

Plani i veprimit si pjesë e kësaj strategjie do të mundësojë lidhjen e saj me reforma dhe strategji të tjera të rëndësishme kombëtare, si: reformën shëndetësore, strategjinë kombëtare të luftës kundër sidës, ndryshimet e mundshme në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, anti-korrupsionin, reformën në gjyqësor etj.

Zbatimi i Strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit do të financohen nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë të tjerë.

3. ANALIZA E SITUATËS

Pozicioni strategjik i Shqipërisë në të ashtuquajturën "Rruga ballkanike" e kushtëzon në një farë mënyre politikën shtetërore që të fokusohet kryesisht në fushën e marrjes së masave kundër trafikut ilegal të drogave dhe prekursorëve.

Rruga ballkanike përdoret kryesisht për trafikimin e një prej drogave më të dëmshme për shëndetin e qytetarëve - heroinës.

Duke pasur parasysh prioritetet e shtetit shqiptar, si dhe përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar kundër trafikut të drogave ilegale, sikurse dhe të përpjekjeve të tij për të luftuar terrorizmin, pasi trafiku i drogave përbën një nga burimet kryesore financiare të financimit të akteve terroriste në nivel ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë është e vendosur të intensifikojë përpjekjet e saj në luftën kundër këtyre aktiviteteve kriminale në territorin e saj, si dhe të kontribuojë në nivelin ndërkombëtar.

Trafikimi i drogave është një nga aktivitetet ilegale më fitimprurëse të krimit të organizuar së bashku me trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën, krimin ekonomik dhe pastrimin e parave.

Shqipëria nuk përbën vetëm një rrugë transitimi të drogave ilegale, por ajo është vendi ku droga kultivohet (kryesisht Cannabis Indica), prodhohet (vaji i hashishit dhe marijuana), tregtohet lokalisht dhe abuzohet.

Të dhënat e kërkesës së parë për mjekim kundër drogë-vartësisë tregojnë për një rritje të vazhdueshme të saj, madje të një trajte eksponenciale (gjatë periudhës 1995-2000). Gjatë dy-tre viteve të fundit kjo rritje e shpejtë duket të jetë ndalur, por arsyet më tepër sesa në vetë ndaljen e fenomenit duhen kërkuar në saturimin e shërbimeve dhe në pamundësinë për të ofruar ndihmë në rast nevojë. Midis atyre që përdorin drogë në mënyrë të rregullt duket se përdoruesit e heroinës janë në proporcion më të lartë.

Shqipëria e njëj rrezikun që vjen nga trafiku i drogave brenda dhe përmes territorit të saj. Grupet kriminale të përfshira në këtë trafik kryesisht i kanë përqendruar përpjekjet e tyre në kalimin e drogave transit përmes Shqipërisë; megjithatë përpjekjet e tyre po përqendrohen edhe në shpërndarjen e drogave brenda vendit. Përpjekjet tona do të përqendrohen kryesisht në luftën kundër kultivimit, prodhimit dhe trafikimit të drogave, duke transituar përmes territorit të Shqipërisë, por edhe kundër trafikimit të tyre brenda territorit të vendit tonë.

Duhet të përmendet se është e rëndësishme të theksohet se rritja e efikasitetit të agjencive të angazhuara në luftën kundër drogave ka rezultuar në rritjen e sasive të konfiskuara dhe ka bërë që grupet kriminale të kërkojnë metoda dhe rrugë të reja të trafikut ilegal.

Për shkak të natyrës serioze të problemeve që lidhen me trafikun e drogave dhe abuzimit me to, është e nevojshme të vlerësohet se deri ku mekanizmat kompetente dhe institucionet i përgjigjen këtij fenomeni. Kemi identifikuar një numër të madh çështjesh që lidhen me funksionimin e strukturave shtetërore të cilat duhet të zgjidhen, me qëllim që të zbatohet siç duhet kjo strategji kombëtare antidrogë.

4. PARIMET KRYESORE DHE QËLLIMET E STRATEGJISË KOMBËTARE

Strategjia kombëtare synon:

- të krijojë një sistem efikas të vlerësimit të rrezikut që lidhet me ofertën për drogë, konsumin dhe efikasitetin e veprimtarive antidrogë;
- të forcojë, të përmirësojë aksionet kundër trafikimit të drogave ilegale dhe prekursorëve, si një pjesë integrale e luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit;
- të përmirësojë ndërveprimin dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe joshetërore të angazhuara në luftën kundër drogave;
- të mbështeten qytetarët dhe veçanërisht të rinjtë në vendimin e tyre individual për një jetë pa drogë;
- të kontrollohen pasojat negative mbi shëndetin publik dhe mbi shoqërinë nga përdorimi i drogës;
- të forcojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe vendet e tjera.

Objektivat e përgjithshme të strategjisë:

1. Të zvogëlojë ofertën, duke përmirësuar efikasitetin e strukturave që merren me luftën kundër trafikut të drogave.
2. Të parandalojë abuzimin me drogat përmes rritjes së ndërgjegjshmërisë publike për rreziqet dhe pasojat negative të përdorimit të substancave psikoaktive, si dhe dhënies së shërbimeve efikase dhe parandaluese.
3. Të reduktojë volumin e tregtimit të paligjshëm të substancave kimike (prekursorëve), të cilat përdoren në fabrikimin ilegal të drogave.
4. Të ofrojë një politikë koordinuese dhe menaxhuese në luftën kundër drogave, si dhe të krijojë sisteme efikase informacioni.

5. DREJTIMET STRATEGJIKE NË ULJEN E OFERTËS PËR DROGË

Shqipëria, pavarësisht nga mangësitë dhe nevojat e saj, po luan një rol të rëndësishëm në përpjekjet ndërkombëtare antidrogë. Vitet e fundit konfiskimet, sidomos të drogave të forta, shënojnë rritje. Qëllimi ynë është të vazhdojmë të jemi një forcë e rëndësishme në këto përpjekje.

Përpjekjet individuale të agjencive kompetente kombëtare do të shndërrohen në një barrierë të fortë ndaj trafikut të drogave dhe krimit të organizuar në përgjithësi. Kërcënimi është i dukshëm dhe përgjigja jonë, mbështetur edhe nga komuniteti ndërkombëtar, duhet të jetë në përputhje me përmasat dhe shkallën e problemit.

Shumë aktivitete janë ndërmarrë në fushën e uljes së ofertës për drogë, të cilat, së bashku me përpjekjet, projektet dhe programet bilaterale, duhet të harmonizohen dhe të koordinohen në këtë strategji.

Kjo do të mundësojë krijimin e mekanizmave konkretë që kjo strategji të çojë më tej arritjet e deritanishme.

Detyrat në uljen e ofertës:

1. Përmirësimi dhe fuqizimi i kontrollit kufitar
2. Funksionimi i Sekretariatit të Komitetit Ndërmnistror të Luftës kundër Drogës dhe i Qendrës së Informacionit dhe të Dhënave.
3. Reduktimi i kultivimit, prodhimit dhe transitimit të drogave, kryesisht i heroinës.
4. Reduktimi i krimeve që lidhen me drogat.
5. Përmirësimi i kapaciteteve analitike lidhur me studimin e barnave narkotike.
6. Përmirësimi i kontrollit të prodhimit legal dhe tregtimit të substancave kimike, prekursorëve për të parandaluar ndryshimin e destinacionit të tyre në prodhimin e drogave ilegale.
7. Zgjerimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet organizmave kombëtarë rajonalë dhe ndërkombëtarë.
8. Përmirësimi i legjislacionit.
9. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve në fushën e uljes së ofertës për drogë.

6. FORCIMI I INSTITUCIONEVE, HARTIMI I POLITIKAVE DHE ZBATIMI

Kjo strategji ka në thelb të saj eksperiencën e vendeve të tjera të Europës, me të cilat pothuajse ndahen të njëjtat probleme. Është koha që të vëmë në veprim mekanizmat të cilat do të na mundësojnë të menaxhojmë me efikasitet problemin kompleks të drogave.

Forcimi i institucioneve është një hap i domosdoshëm që do të mundësojë zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të kësaj strategjie.

Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të luftës kundër drogës ka për detyrë:

- Miratimin e rregullores së veprimtarisë së Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të luftës kundër drogës
- Miratimi i strategjisë së luftës kundër drogës;
- Miratimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë;
- Funksionimin e stafit të specialistëve që përfaqësojnë institucionet anëtare të Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të luftës kundër drogës;
- Funksionin e Zyrës së Sistemit Kombëtar të të dhënave për drogën me të dhënat e përcaktuara në ligj;
- Koordinimin e veprimtarive të institucioneve në zbatim të orientimeve apo vendimeve të Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të luftës kundër drogës;
- Monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare antidrogë.

Agjencitë kombëtare të angazhuara në luftën kundër uljes së ofertës për drogë

Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) dhe Prokuroria e Përgjithshme janë institucionet përgjegjëse në hetimin dhe luftën kundër trafikut ilegal, shpërndarjes, kultivimit dhe prodhimit të drogave.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Aktiviteti i këtij institucioni do të përmbledhë:

- Hartimin e akteve nënligjore që lidhen me luftën kundër narkotikëve në zbatim të ligjeve të miratuara në fushën e drogës;
- Krijimin e një strukture qendrore në nivel drejtorie, që do të merret me luftën kundër krimit të organizuar dhe përcaktimin e një misioni të qartë të veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat në ligjet e miratuara në fushën e drogës;
- Forcimin dhe fuqizimin e strukturave të specializuara që merren me luftën kundër veprave penale në fushën e krimit të organizuar si në aspektin teknik, ashtu dhe në atë të personelit policor.
- Krijimin e infrastrukturës operationale dhe financiare për aplikimin e disa teknikave specifike të luftës kundër drogës si operationet *undercover*, infiltrimet, si dhe metodikën e aplikimeve të këtyre operationeve;

- Trajnimin e vazhdueshëm të personelit të strukturave të specializuara të luftës kundër drogës nëpërmjet programeve të Akademisë së Rendit Publik, të organizmave të huaja policore apo të shërbimeve homologe që ofrojnë trajnime të tilla;

- Hartimin e projekteve të nevojshme për shfrytëzimin e financimeve nga donatorë ose partnerë të huaj;

- Zbatimin e marrëveshjeve të arritura në fushën policore dhe rifreskimi i tyre nëpërmjet protokolleve të bashkëpunimit;

- Shkëmbimin e përvojës nëpërmjet kontakteve të grupeve teknike me policitë e vendeve të huaja;

- Forcimin e strukturave të Policisë së Shtetit për sigurimin dhe forcimin e kontrollit në kufijtë e Shqipërisë dhe në rrugët kombëtare;

- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me:

- Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës për parandalimin e fenomenit të përdorimit dhe të shpërndarjes në mjedise shkollore të substancave narkotike;

- Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit "Për forcimin e masave të kontrollit për parandalimin e importit, shumëzimit dhe tregtimit të materialit mbjellës të bimëve narkotike, në veçanti të Cannabis Indica";

- Ministrinë e Shëndetësisë "Për forcimin e masave të kontrollit ndaj prekursorëve dhe barnave narkotike (drogave mjekësore)";

- Konkretizimin e zbatimit e Memorandumit të mirëkuptimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

- Konkretizimin e zbatimit e Memorandumit të mirëkuptimit me SHISH-in;

- Rritjes së efikasitetit të strukturave të Policisë së Shtetit dhe atyre të specializuara për luftën kundër drogës për shtypjen e trafikut të paligjshëm dhe qëndrimet rigoroze në aplikimin e masave ligjore;

- Koordinimin e detyrimeve të strategjive të miratuara të strukturave të saj me strategjinë e luftës kundër drogës;

- Hartimin e strategjive të tjera për forcimin e regjimit kufitar dhe të hetimit të krimeve në fushën e pastrimit të parave dhe krimit ekonomiko-financiar;

- Pastrimin e radhëve të policisë nga elementë të implikuar në veprimtari kriminale;

- Zbatimin e projekteve që ofrojnë organizmat ndërkombëtarë (projektet CARDS dhe TIM);

- Bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare që organizojnë partnerët tanë apo institucionet ndërkombëtare.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Aktiviteti i saj do të përmblihet në:

- Ndryshimet strukturore të grupit të antidrogës në Departamentin Operativo-Hetimor të doganave, nëpërmjet krijimit të bërthamave antidrogë në vendkalimet kufitare;

- Hartimin e amendamenteve shtesë të Kodit Doganor për futjen e misionit të veprimtarisë për kapjen dhe hetimin e rasteve të trafikut të drogës;

- Vënien në efijencë të shërbimeve të saj, të Policisë Gjyqësore në hetimet e trafikut ndërkombëtar të drogave që realizohen nëpërmjet vendkalimeve kufitare e doganore;

- Shkëmbimin e detyrueshëm të informacioneve me strukturat e Policisë së Shtetit, që kanë të bëjnë me subjekte të dyshuara për trafikun e prekursorëve;

- Pastrimin e radhëve për përjashtimin e elementëve të strukturave të saj në pikat doganore të implikuara në trafike të paligjshme apo që shpërdorojnë detyrën.

Prokuroria e Përgjithshme

Aktiviteti i këtij institucioni do të përmblihet në:

- Hetimin në thellësi të veprimtarisë së trafikut të drogës dhe të pasurive me prejardhje nga ky trafik;

- Hetimin e parave të pista dhe aktiviteteve ekonomike që rrjedhin nga traliku i paligjshëm i narkotikëve;

- Bashkëpunimin me partnerët jashtë vendit në bazë të marrëveshjeve të lidhura "Për ndihmën juridike për çështjet penale" të subjekteve që zhvillojnë aktivitet kriminal të trafikut ndërkombëtar të drogave;
- Vënien në funksionim dhe me efektivitet të strukturave të ngritura për hetimin e krimeve të rënda;
- Zbatimi i dispozitave të Procedurës Penale për konfiskimet e mjeteve që përdoren për trafikun e drogës;
- Sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit hetimor të strukturës së Task-Forcës për hetimin e veprave penale në fushën e krimit të organizuar;
- Shkëmbimin e informacioneve me institucionet qendrore, Ministrinë e Rendit Publik dhe SHISH-in për implikimet që mund të dalin për pjesëtarët e këtyre institucioneve në trafikun e drogës.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

Aktiviteti i kësaj drejtorie, si një qendër kombëtare, ka përgjegjësinë për të marrë, për të kërkuar, për të analizuar dhe për t'u shpërndarë autoriteteve kompetente zbulimin ose ekspozën e informacionit financiar:

- lidhur me të ardhurat që dyshohen të kenë origjinë kriminale dhe sipas kërkesave të bëra nga rregullatorët dhe ligjvënësit vendas, në mënyrë që të luftohet pastrimi i parasë dhe trafiku i drogës.

Realizimi i këtyre drejtimeve të rëndësishme do të përmblihte:

- Shkëmbimin e informacioneve me strukturat e specializuara të luftës kundër krimit të organizuar për transaksionet e veprimet e dyshimta;
- analizimin e tyre me qëllim investigimin;
- dhënien e përfundimeve prokurorisë, Policisë Gjyqësore dhe organeve të tjera kompetente ligjore.

Shërbimi Informativ i Shtetit

Shërbimi Informativ i Shtetit ka për detyrë grumbullimin dhe transmetimin e informacionit tek institucionet e tjera të përfshira në luftën ndaj fenomenit drogë. Aktiviteti i këtij institucioni do të përmblihet në:

- Grumbullimin e informacionit për identifikimin e rrjeteve dhe grupeve kriminale, kombëtare dhe ndërkombëtare të trafikut të drogës që përdorin Shqipërinë si bazë dhe vend transiti;
- Ristrukturimin dhe përsosjen e organizimit të brendshëm të strukturave funksionale në përshtatje me intensitetin dhe përqendrimin e problemeve të fenomeneve të narkotrafikut;
- Rritjen e fuqisë zbuluese nëpërmjet infiltrimit të burimeve të informacionit dhe mjeteve tekniko-shkencore, në funksion të zbulimit, të dokumentimit dhe të parandalimit të aktiviteteve kriminale në trafikun e drogës;
- Bashkërendimin me strukturat e specializuara të luftës kundër drogës në Policinë e Shtetit, duke i dhënë përparësi elementëve operacionale për kapjen në flagrancë të personave apo grupeve kriminale gjatë zhvillimit të aktivitetit të trafikut të paligjshëm të drogës;
- Intensifikimin e kontakteve me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në funksion të krijimit të grupeve të përbashkëta për forcimin e kontrolleve nëpërmjet pajisjeve të domosdoshme për identifikimin e shtetasve të përfshira në rrjetet e trafikut të drogës;
- Koordinimin e veprimtarive me Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave) për identifikimin e aktiviteteve, të bizneseve, të pronave dhe të pasurive të trafikantëve të përfshuara nga trafiku i paligjshëm i drogave nëpërmjet mekanizmave të pastrimit të parasë;
- Hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta me shërbimet partnere në luftë kundër narkotrafikut ndërkombëtar;
- Reformimin tërësor të punës në mbledhjen e informacionit, që ai të jetë i saktë dhe i verifikuar si bazë e ndërtimit të operacioneve të përbashkëta me Policinë e Shtetit;
- Gjetjen e rrugëve efikase për shkëmbimin sa më të shpejtë të informacioneve midis atij që e zotëron dhe përdoruesit të tij dhe evitimin e problemeve që lidhen me rrjedhjen e informacionit;
- Instalimin e rrjetit unik kompjuterik me programe mundësisht 1-2 për përpunimin dhe për analizën e shpejtë të të dhënave të disponuara;

- Krijimin dhe mbështetjen e veprimtarisë informative me infrastrukturë të plotë ligjore në luftën kundër trafikut të drogës;

- Hartimin e akteve ligjore e nënligjore për "Mbrotjtjen e burimeve të informacionit që merren nga SHISH-i";

- Shkëmbimin e informacioneve të verifikuara me strukturat e Policisë së Shtetit për veprimtari konkrete të trafikut të paligjshëm të drogës apo dhe për probleme të çështjeve në hetim;

- Përfundimin e projektit të interceptimeve të celularëve (ETI) në thellimin e proceseve informative, të hetimeve për veprime të shpejta goditëse e grumbullimin e provave ligjore.

Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të bëjë kontroll të plotë të dokumentacionit të subjekteve që merren me eksport/importin e prekursorëve, sigurimin e informacionit të vazhdueshëm për strukturat e specializuara të luftës kundër drogës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të gjitha subjektet e autorizuar për eksport/importin e prekursorëve, forcimin e masave të kontrollit ndaj objekteve ku përgatiten përgatesat e parashikuara në tabelat 2 dhe 3 të ligjit "Mbi barnat narkotike dhe psikotrope" dhe atyre që tregtojnë droga mjekësore.

Ministria e Mbrotjtjes (Shërbimi Informativ Ushtarak)

Aktiviteti i këtij institucioni do të përmblihet në:

- Shfrytëzimin e përdorimin e të gjithë kapaciteteve dhe mundësive në punën e koordinuar për luftën kundër narkotrafikut;

- Përdorimin me efektivitet i Rojës Bregdetare, në bashkëpunim me Ministrin e Rendit Publik dhe me institucionet e tjera;

- Forcimin e bashkëpunimit kryesisht me strukturat e Policisë së Shtetit të zonave bregdetare për realizimin e detyrimeve ligjore;

- Bashkëpunimin me të gjitha institucionet shtetërore që kanë detyra duke koordinuar komponentët për ruajtjen e "kufirit blu";

- Rritjen e bashkëpunimit me SHISH-in për koordinimin e masave në fushën e informacionit dhe të bashkëveprimit për zbulimin e aktivitetit të trafikut të paligjshëm të drogës;

- Realizimin e bashkëpunimit me shërbimet partnere për njohjen e situatës së trafikut të drogës në vendin tonë dhe në rajon;

- Vlerësimin e të dhënave dhe informacioneve që bëjnë fjalë për rafun e drogës me subjekte të juridiksionit ushtarak, duke marrë masat e nevojshme për ezaurimin e tyre.

Legjislacioni

Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në hartimin e legjislacionit vendas në fushën e luftës kundër drogave. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë specifikon veprat penale në fushën e drogave dhe të krimeve që lidhen me to. Ndërsa Kodi i Procedurës Penale specifikon procedurat për hetimin dhe penalizimin e këtyre krimeve. Në hartimin e ligjeve janë marrë parasysh modellet e legjislacioneve të vendeve të përparuara europiane dhe të Kombeve të Bashkuara. Kështu është vepruar në hartimin e ligjeve: "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope" (1995), "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope" (2001), "Për kontrollin e lëndëve që shërbejnë për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike ose psikotrope" (2002).

Gjithashtu, janë hartuar dhe aprovuar një sërë aktesh nënligjore, të cilat mundësojnë zbatimin rigoroz të ligjeve.

Marrëveshjet ndërkombëtare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Republika e Shqipërisë është anëtare e tri konventave të Kombeve të Bashkuara për kontrollin mbi drogat:

1. Konventës së vetme mbi substancat narkotike (1961);
2. Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi substancat psikotrope (1971);
3. Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi trafikun ilegal të drogave (1988).

Qeveria shqiptare është e ndërgjegjshme në rolin që luan bashkëpunimi ndërkombëtar me organizmat e huaja qoftë në nivelin politik, ashtu dhe në atë tekniko-profesional. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje e protokolle bashkëpunimi dypalëshe e shumëpalëshe në fushën e sigurisë e të rendit publik me Italinë, Turqinë, Greqinë, Rumaninë, Kroacinë, Slloveninë, Bullgarinë, R.A. Egjiptit, Federatën Ruse, R.P të Kinës, Austrinë, Hungarinë, BEDZ (Nisma e bashkëpunimit të

Detit të Zi, SECI (Qendra e Këmbimit të Informacionit të Europës Juglindore), ICMPD (Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikave të Migrimit), Malin e Zi, Maltën.

Ministria e Rendit Publik ka oficerët e saj të kontaktit pranë ministrive respektive të Turqisë, Italisë, Greqisë dhe administratës së UNMIK/Kosovës.

7. PRINCIPET LIDHUR ME REDUKTIMIN E KËRKESËS PËR DROGË

7.1 Qëndrimi i balancuar që kombinon spektrin e gjerë të iniciativave parandaluese

Strategjia bazohet në një përjasje të balancuar që kombinon masat në fushën e parandalimit, kurimit, rehabilitimit, si dhe në atë të minimizimit të rreziqeve, përfshirë këtu parandalimin e HIV/AIDS dhe hepatiteve virale. Konsideratë e veçantë i jepet bashkëpunimit me organizmat që ushtrojnë ligjin, për të siguruar balancimin midis iniciativave të reduktimit të kërkesës dhe furnizimit me drogë. Principet kryesore janë:

- Fillimi i hershëm i iniciativave parandaluese, në mënyrë që të sigurohet një stil i shëndetshëm i jetesës gjatë viteve të formimit të popullatës target, fëmijëve dhe rinisë;
- Planifikimi dhe menaxhimi i aktiviteteve komplekse dhe gjithpërfshirëse të reduktimit të kërkesës për drogë për të maksimalizuar efektin parandalues;
- Planifikimi dhe zbatimi sistematik dhe afatgjatë i programeve parandaluese për të siguruar vazhdimin dhe ndërthurjet sinergjike të iniciativave të ndryshme;
- Planifikimi dhe zbatimi i iniciativave dhe programeve që reduktojnë dëmet e drogës tek të ekspozuarit;
- Ndërhyrje specifike ndaj grupeve të identifikuara si grupe në rrezik.

7.2 Bashkëpunimi ndërministror, ndërsektorial, ndërdisiplinor dhe ndërkombëtar

Lidhur me karakterin kompleks të tij, reduktimi i kërkesës për drogë mund të ndiqet me sukses vetëm nëpërmjet përjasjeve sistematike dhe afatgjata, që lidhin fushat e sistemit të arsimit, shëndetit publik dhe sektorit social në nivelet qeveritare dhe joqeveritare. Si rrjedhojë, reduktimi i kërkesës synon:

- Bashkëpunimin ndërmjet ministrive përkatëse (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave);
- Bashkëpunimin ndërmjet disiplinave të ndryshme, fushave të edukimit, kërkimit, trajnimit dhe trajtimit;
- Bashkëpunimin midis sektorit qeveritar dhe sektorit joqeveritar për të siguruar përfshirjen dhe bashkëpunimin e agjencive dhe institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse, organizatave bamirëse, shoqërive fetare dhe sektorit privat;
- Bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtarë të përfshira në fushën e luftës kundër drogës, në mënyrë që të përdoret sa më shumë eksperiencë dhe asistencë e huaj;
- Integrimi i të gjitha iniciativave dhe programeve të reduktimit për drogë në strategjinë kombëtare të reduktimit të varfërisë.

7.3 Qëndrim racional, realist dhe pragmatik

Politika e reduktimit efektiv të kërkesës për drogë bazohet në vlerësimin e saktë të problemit, planifikimin dhe përdorimin e rrugëve parandaluese efektive. Si rrjedhim, objektivat reale dhe të arritshme janë caktuar, duke respektuar sistemin ekzistues shqiptar të arsimit, shëndetit publik dhe asistencës sociale.

Duke marrë parasysh burimet e kufizuara financiare dhe humane, reduktimi i kërkesës ndërtohet, duke u përqendruar në ato aktivitete parandaluese dhe mjekuese, të cilat do të kenë rezultatet e pritshme sa më shpejt të jetë e mundur.

7.4 Vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë

Së pari del e rëndësishme aplikimi i studimeve epidemiologjike, me qëllim vlerësimin e besueshëm të problemit. Më pas, cilësia e pritshme e të gjitha ndërhyrjeve të ushtruara do të vlerësohet dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar maksimumin e efektivitetit të kostos të aktiviteteve lidhur me reduktimin e kërkesës. Një vlerësim i tillë do të bëhet çdo vit edhe me mbështetjen e ekspertizës së huaj.

8 QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E REDUKTIMIT TË KËRKESËS

8.1 Qëllimet

Qëllimi kryesor i reduktimit të kërkesës për drogë është të ulë kërkesën në rritje për drogën e paligjshme dhe impaktin e saj negativ mbi gjithë shoqërinë nëpërmjet:

- Mbështetjes së qytetarëve dhe veçanërisht të të rinjve në vendimin e tyre individual për një jetë pa drogë;
- Kontrollit të pasojave negative mbi shëndetin publik dhe mbi shoqërinë nga përdorimi i drogës.

Qytetarët duhet të mbrohen nga oferta e drogës së paligjshme dhe duhet të informohen në mënyrë që të marrin një vendim për një jetë pa drogë. Duhet siguruar informacioni, edukimi, asistenca mjekësore, si dhe mbështetja për riintegrim.

8.2 Objektivat specifike

Qeveria duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtme për reduktimin e kërkesës për drogë:

Fusha e parandalimit parësor (duke përfshirë ndërhyrjen e hershme):

- Rritja e ndërgjegjshmërisë publike për rreziqet dhe pasojat negative të përdorimit të substancave psikoaktive, ku duhet përtheksuar roli i masmedias;
- Rritja e nivelit të njohurive, cilësisë së qëndrimeve dhe aftësive për t'i rezistuar drogëpërdorimit në nxënësit e sistemit parauniversitar, nëpërmjet forcimit të kurrikulave shkollore lidhur me parandalimin e drogës dhe nëpërmjet mbështetjes efektive të programeve parandaluese;
- Trajnimi i grupeve target të mediatorëve (mësuesit, mjekët dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor parësor, punonjësit socialë, bashkëmoshatarët etj.), që veprojnë në fushën e parandalimit parësor;
- Përfshirja aktive e të rinjve në programet parandaluese nëpërmjet grupeve të tyre përfaqësuese apo individuale, si dhe integrimi i këtyre programeve në shërbimet sociale, shëndetësore apo arsimore në mënyrë që këto shërbime të jenë sa më miqësore për të rinjtë;
- Përfshirja e komuniteteve lokale, autoriteteve bashkiake dhe lokale në aktivitetet parandaluese parësore që kanë për shënjestër të rinjtë në rrezik në mjedisin shkollor (shkollë), familjar (familje) apo komunitar (komunitet lokal);
- Ndërmarrja e programeve të ndërhyrjes së shpejtë dhe shërbimeve ndaj popullatës së fshehtë (popullatë me vështirësi identifikimi).

Fusha e parandalimit dytësor (mjekimi dhe rehabilitimi):

- Rritja e mundësisë për mjekim (trajtim, kurim);
- Krijimi i një sistemi kurimi ose trajtimi kompleks dhe të lidhur me risocializimin e grupeve apo individëve të prekur (drogëpërdorues);
- Arsimimi profesional i punonjësve të shëndetësisë dhe të punës sociale dhe rritja e përhershme e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimeve.

Fusha e parandalimit tretësor (duke përfshirë reduktimin e dëmit):

- Ulja e pasojave shëndetësore dhe sociale të përdorimit të drogës, duke përfshirë parandalimin e sëmundjeve të transmetueshme.

Fusha e sistemeve të informimit mbi drogën dhe vlerësimi i nevojave:

- Dhënia e vlerësimit të shpejtë të situatës së drogës në Shqipëri nëpërmjet kombinimit të teknikave sasiore dhe cilësore;
- Ndërtimi i rrjetit të mbikëqyrjes epidemiologjike lidhur me problemet e drogëpërdorimit dhe drogabuzimit në drejtim të shëndetit publik;
- Krijimi i një *database* dhe i një qendre burimore mbi aktivitetet dhe publikimet në fushën e reduktimit të kërkesës për drogë në drejtim të shëndetit publik.

9 DETYRAT KRYESORE LIDHUR ME ULJEN E KËRKESËS PËR DROGË

9.1 Parandalimi parësor

Principet e mëposhtme konsiderohen në përgjithësi baza e një plani parandalimi efektiv:

- Përqasje afatgjatë dhe gjithpërfshirëse;
- Fillimi i hershëm i aktiviteteve të parandalimit;
- Ndërhyrje në popullatën në rrezik;

- Metodologji ndërvepruese që përqendrohet në ndikimin ndaj qëndrimeve dhe sjelljes së rrezikshme;

- Nxitje e faktorëve mbrojtës në nivelin e individit, familjes, bashkëmoshatarit dhe komunitetit;

- Përtheksim i promovimit shëndetësor që përfshin rrezikun e përdorimit të drogës së paligjshme.

Programet e parandalimit mbulojnë një gamë të gjerë aktiviteteve që përfshijnë:

1. fushata të masmedias;
2. programe në shkolla;
3. programe në komunitet.

9.2 Parandalimi dytësor dhe tretësor

Sistemi gjithëpërfshirës i shërbimeve për drogëpërdoruesit problematikë dhe drogëvartësit përfshin:

- aktivitetet për arritjen e popullatës së fshehtë (drogëpërdoruesit e panjohur);
- aktivitetet në qendrat e pragut të ulët të kontaktit (qendrat e pranimit);
- trajtimin ambulator;
- trajtimin ambulator intensiv;
- detoksikimin spitalor;
- trajtimin spitalor afatshkurtër dhe afatmesëm;
- trajtimin afatgjatë në qendrat rezidenciale dhe rehabilitimin social në komunitetin terapeutik;

- pastrajtimin.

Realizimi i të gjithë komponentëve të mësipërm brenda një periudhe të kufizuar kohe duket të jetë përtej mundësive aktuale të Shqipërisë. Rrjedhimisht, strategjia paraqet një vizion të moderuar dhe realist lidhur me burimet ekzistuese që përdoren, rritjen e kapaciteteve ekzistuese dhe stimulimin e zhvillimit të mëtejshëm.

Strategjia adresohet në 3 nivele "strategjike":

1. Modeli i shërbimeve në Tiranë dhe zonën periferike të saj;
2. Modeli i shërbimeve për zona të tjera me risk të lartë (konkretisht Durrës, Shkodër, Vlorë, Berat);
3. Infrastruktura (koordinimi, trajnimi, zhvillimi i kurrikulave, përcaktimi i standardeve etj.).

Infrastruktura trajnuese për aktivitetet e parandalimit dytësor dhe tretësor

Ky nivel është i nevojshëm për ngritjen dhe mbajtjen e shërbimeve në kuptimin e koordinimit, trajnimit, zhvillimit të kurrikulave, ngritjes së standardeve etj. Veçanërisht, ka nevoja për trajnim pothuajse në çdo nivel. Për t'i kapërcyer ato gradualisht, por edhe sistematikisht propozohet:

1. Rishikimi i kurrikulave dhe kapaciteteve mësimdhënëse ekzistuese.
2. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve mësimdhënëse në fazën e parë të formohet një grup profesionistësh shumë të kualifikuar që do të mund të luajnë një rol udhëheqës kyç në shërbimet e propozuara për të mbikëqyrur qendrat dhe programet e tjera dhe për të trajnuar trajnuesit e tjerë.
3. Ngritja e kapaciteteve trajnuese dhe mësimdhënëse në metodat psiko-sociale të trajtimit (terapi të sjelljes njohëse, terapi grupi, terapi dhe këshillim individual dhe familjar). Propozimi për zhvillimin e këtij sistemi shërbimesh varet nga njohuritë dhe aftësitë në këtë disiplinë dhe nuk mund të bëhet pa to; megjithatë, trajnime të tilla nuk ekzistojnë në Shqipëri dhe njohuritë janë shumë të kufizuara.
4. Trajnimi i personelit që punon ose që do të punojë në sistemin e shërbimeve speciale.
5. Plotësimi i nevojave të trajnimit me një numër të madh mjekësh të familjes dhe punonjës socialë.
6. Skicimi i të gjitha programeve të trajnimit lidhur me nevojën për të rritur potencialin profesional në mënyrë graduale nëpërmjet principit të "ortekut" d.m.th, trajnim jo vetëm për punën praktike me pacientin apo klientin, por po ashtu edhe për transferimin e njohurive dhe aftësive.

Çështje të veçanta në sistemin e shërbimeve Reduktimi i dëmit (RD)

Aktivitetet në programet e RD-së përfshijnë shkëmbim të ageve dhe shiringave, informim, referencë, teste për HIV/AIDS dhe për hepatitet virale B dhe C, si edhe sesione të shkurtra këshillimi. Shkëmbimi i ageve dhe shiringave është një aktivitet në interes të shëndetit publik, prandaj materialet (shiringat-aget) duhet të jepen mundësisht falas dhe jo të blihen me çmimet e tregut.


Mbajtja me metadon

Programet e mbajtjes me metadon (terapi zëvendësuese afatgjatë) kanë nevojë të koordinohen dhe mbikëqyren nga qendrat e specializuara. Një grup specialistësh pranë Ministrisë së Shëndetësisë duhet të përcaktojë si protokollet e trajtimit, ashtu edhe kriteret e dhënies së metadonit.

Nga ana tjetër, që të jenë të suksesshme programet e mbajtjes me metadon kërkojnë nivel të ulët pragu lidhur me aksesin, çka do të thotë përdorim i shpejtë dhe pa probleme i shërbimit nga klientët. Kjo mund të realizohet me mbështetjen e disa qendrave që operojnë në nivelin e kujdesit parësor.

Grupe në të cilët pjesëmarrësit ndihmojnë njëri-tjetrin


Nuk ekzistojnë aktualisht në Shqipëri. Për të lehtësuar ngritjen e tyre, çdo qendër trajtimi dhe rehabilitimi duhet të krijojë kushtet për aktivitete ku pjesëmarrësit mund të ndihmojnë vetveten, t'i promovojë ato aktivitete dhe të bashkëpunojë në zhvillimin e tyre.




Sipas të dhënave të Shërbimit Qendror të Luftës Kundra Drogës



Sipas të dhënave të Shërbimit Qendror të Luftës Kundra Drogës



Sipas te dhenave te Ministrise se Drejtesise
Raporti i Grupit te Mini Dublinit



Sipas te dhenave te Repartit te Toksikologjise

Grupi ndërmintor i punës për hartimin e strategjisë të luftës kundër drogës

Thoma Jano, zëvendësministër i Rendit Publik	Kryetar i Grupit
Izet Shameti, përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë	Anëtar
Lorenc Xhaferaj, përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme	Anëtar
Pavli Gjika, përfaqësues i Ministrisë së Financave	Anëtar
Prof.As. Dr.Irena Vangjeli, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës	Anëtare
Genta Bungo, përfaqësuese e Ministrisë së Pushtetit Vendor e të Decentralizimit	Anëtare
Eduart Manushi, përfaqësues i Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sporteve	Anëtar
Natasha Pepivani, përfaqësuese e Ministrisë së Punës dhe e Çështjes Sociale	Anëtare
Alban Ylli, përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë	Anëtar
Shpëtim Guri, përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe i Ushqimit	Anëtar
Nënkolonel Emrush Rec, përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes	Anëtar
Kryekomisar Shkëlqim Saço, Komisar Arian Stefi	
Përfaqësues të Ministrisë së Rendit Publik	Anëtar
Ardian Visha, përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme	Anëtar
Sokol Gashi, përfaqësues i Shërbimit Informativ të Shtetit	Anëtar

VENDIM

Nr.294, datë 14.5.2004

**PËR LEJIMIN E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE TË PËRDORË
PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË" PËR PRODHIMIN E MJETEVE
LËVIZËSE PËR INVALIDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 67 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore që, për fondin prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" me fondacionin shqiptar "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", për prodhimin e mjeteve lëvizëse për invalidë, sipas termave të referencës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

Termet e referencës

Sasia 160 copë

Fondi 4 000 000 lekë

Përshkrimi i detajuar i mallit, karrige me rrota për invalidë.

Të dhëna teknike

- Struktura (materiali) çelik
- Përmasat 95 x 60 x 90 h
- Volumi 0,52 m³
- Pesha 16,5 kg

Të dhëna të përgjithshme

- Struktura çeliku e lyer me material të paoksidueshëm;
- Material sintetik mbajtës ipoalergjik, material që lahet dhe që mund të hiqet lehtësisht në rast zëvendësimi;
- Pedana për vendosjen e këmbëve të rregullueshme, të fiksuara dhe të çmontueshme;
- Doreza të veshura në pjesën e prapme për shoqëruesin;
- Karrige me rrota e dizenuar për zona rurale dhe urbane;
- Gomat e pasme 20" 24";
- Gomat e para 0 100, 125 dhe 150, mishi ose tubolare;
- Këndi i gomave të pasme 0-12 gradë.

VENDIM

Nr.295, datë 14.5.2004

PËR CAKTIMIN E SELIVE DHE TË REZIDENCAVE, QË DO TË RUHEN DHE DO TË MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e selive dhe të rezidencave, që do të ruhen dhe do të mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë, të cilat janë si më poshtë vijon:

- Selia e Presidencës;
- Selia e Kryeministrit;
- Selia e Kryesisë së Kuvendit;
- Selia e Sallës Parlamentare të Kuvendit;
- Selia e Gjykatës Kushtetuese;
- Selia e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Selia e Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- Rezidencat: Vilat nr.4, nr.30, nr.31 në Tiranë, vilat nr.1 e nr.2 në Dajt, Tiranë, vilat nr.5, nr.6, nr.13, nr.17, nr.19/1, nr.20 dhe nr.23 në Durrës, vilat nr.6 dhe nr.9 në Vlorë, vila në Dhërmi e Sarandë në qakun e Vlorës, vilat nr.1, nr.2, nr.3, nr.4 e nr.5 në Pogradec dhe vilat në Ishull Lezhë në Lezhë;
- Objektet që shërbejnë si seli dhe rezidenca në Dajt, Kërrabë dhe Linzë.

2. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik dhe komandanti i Gardës së Republikës të Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.296, datë 14.5.2004

PËR NGRITJEN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL TË AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR "NËNË TEREZA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8310, datë 19.3.1998 "Për sigurinë e aviacionit civil shqiptar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", me synim sigurimin dhe zbatimin e masave të sigurimit në këtë aeroport.

2. Veprimtaria e këtij komiteti zhvillohet në mbështetje të ligjeve nr.7877, datë 30.11.1994 "Për aviacionin civil shqiptar" dhe nr.8310, datë 19.3.1998 "Për sigurinë e aviacionit civil shqiptar", të ndryshuar, të konventës së Çikagos (aneksi 17 dhe Dok.8973 i ICAO-s, Organizata Botërore e Aviacionit Civil), të programit kombëtar të sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë, të programit të sigurisë së Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", të vendimit nr.361, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e aneksit shtesë të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore", (strategjia 2002-2003 e ICITAP, programi ndërkombëtar i asistencës trajnuese për investigimin e krimit në Shqipëri, për antitrafikun dhe antiterrorizmin), të memorandumit të mirëkuptimit "Për përmirësimin e masave të sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" dhe të marrëveshjes ndërkombëtare dy e shumëpalëshe (pjesët për sigurinë).

3. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Zhvillon, bashkërendon dhe zbaton masat e procedurat e sigurisë për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza";

- Zhvillon dhe zbaton masat e sigurisë, në përputhje me programin kombëtar të sigurisë së aeroportit;

- Zhvillon dhe zbaton masat e sigurisë, në përputhje me programin e sigurisë së aeroportit;

- Zbaton standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare, në përputhje me aneksin 17 (Siguria), Dok.8973 (Manuali i sigurisë), të ICAO-s, Dok.30 (Sigurisë) e ECAC (Konferenca Europiane e Aviacionit Civil) dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, dy e shumëpalëshe;

- Harton listën e zonave të dobëta për sigurinë në aeroport dhe bën azhurnimin e kësaj liste;

- Garanton marrjen e masave të sigurisë dhe të procedurave bazë të përshtatshme, si në rastet e gjendjeve normale e emergjente, edhe në raste kërcënimesh;

- Organizon vëzhgimin e sigurisë së aeroporteve në mënyrë periodike;

- Vë në dijeni autoritetet përgjegjëse për sigurinë, për masat dhe procedurat e sigurisë për mbrojtjen e aeroportit dhe të shërbimeve të tjera që realizohen në të;

- Harton kërkesat dhe nevojat për mbrojtjen e sigurisë në aeroport kur ato tejkalojnë mundësitë dhe kompetencat e këtij komiteti;

- Organizon trajnimin e stafit të aeroportit për sigurinë;

- Garanton zbatimin e planit të ndryshimeve për pajisjet dhe sistemin e kontrollit të sigurisë së aeroportit, gjatë punimeve për zgjerimin e këtij aeroporti.

4. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" të kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Aeroportit dhe të ketë në përbërje këta persona:

- Shefin e komisarariatit të policisë, Rinas zëvendëskryetar;

- Kryetari i degës së doganës, Rinas zëvendëskryetar;

- Përfaqësuesin e operuesve të linjave ajrore anëtar;

- Drejtorin e sigurisë së Aeroportit Ndërkombëtar anëtar;

- Drejtorin e ANTA-s (Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror) anëtar;

- Shefin e imigracionit në aeroport anëtar;
- Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil anëtar;
- Komandantin e detashmentit ajror (aviacioni ushtarak) anëtar;
- Shefin e Policisë së Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit anëtar;
- Shefin e shërbimit postar anëtar;
- Përfaqësuesin e subjekteve qiramarrëse në Aeroportin Ndërkombëtar (Duty Free, BP, DHL) anëtar.

Sekretari i këtij komiteti është anëtar teknik, pa të drejtë vote.

Në Komitetin e Sigurisë së Aviacionit Civil të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" marrin pjesë, si anëtarë këshillues, pa të drejtë vote, edhe përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, që merren me çështjet e menaxhimit të kufirit, nga ASAP-A, Komiteti Këshillimor i Sigurisë së Aviacionit për Shqipërinë (ICITAP, CAM-A, Misioni i Asistencës Doganore për Shqipërinë, INTERFORZA, PAMECA, Misioni i Asistencës Policore të Komitetit European për Shqipërinë).

Në mbledhjet e këtij komiteti, në mbështetje të problematikave, mund të ftohen edhe përfaqësues të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në aeroport.

Në të gjitha rastet është i detyrueshëm identifikimi i personave, që do të marrin pjesë në mbledhje.

5. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" mbledhet jo më rrallë se një herë në dy muaj me kërkesë të kryetarit ose, në raste të veçanta, me kërkesën e 1/3 së numrit të anëtarëve të këtij komiteti, por pas miratimit të kryetarit dhe të zëvendëskryetarëve.

Anëtarët këshillues nuk e gëzojnë të drejtën për thirrjen e mbledhjes.

6. Data, ora e rendi i ditës i mbledhjes u njoftohen me shkrim anëtarëve (edhe anëtarëve këshillues) të paktën 4 ditë para mbledhjes.

7. Rezultatet dhe vendimet e mbledhjes u shpërndahen anëtarëve të komitetit (dhe anëtarëve këshillues) me shkrim, brenda 7 ditëve nga dita e mbajtjes së mbledhjes.

8. Mbledhja e komitetit regjistrohet në audio dhe zbardhet nga sekretari i Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza".

9. Dokumentacioni dhe materialet e përdorura në mbledhjen e këtij komiteti arkivohen dhe nuk mund të përdoren pa autorizimin e kryetarit.

10. Përfaqësuesi i operuesve të linjave ajrore zgjidhet me rotacion ndërmjet operatorëve të linjave ajrore, që operojnë në aeroport.

11. Përfaqësuesi i subjekteve qiramarrëse të aeroportit zgjidhet me rotacion për një periudhë 6-mujore ndërmjet subjekteve qiramarrëse, që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza".

12. Vendimi nr.427, datë 19.11.1998 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil të Aeroportit", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.298, datë 14.5.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5 e kapitullit I "Sigurimi i detyrueshëm" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në moshën për pension sipas nenit 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, kur banojnë në të njëjtin rreth ku kanë tokën në pronësi, të fituar nga ligji për tokën, dhe zhvillojnë veprimtari, bujqësore e blegtorale, sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, për barrë lindjen, për pensione dhe për sigurim shëndetësor."

2. Paragrafi i parë i pikës 6 të kapitullit III "Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontributin vjetor për sigurimet shoqërore në masën 7820 lekë, me përjashtim të rretheve Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilat masa e kontributit vjetor është 5390 lekë."

3. Paragrafi i shtatë i kapitullit V "Pagesa e kontributeve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.5.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.299, datë 14.5.2004

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.281, DATË 2.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AKADEMISË SË POLICISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 pika 1 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të nenit 29 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të nenit 69 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.281, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titull dhe kudo në tekst, pas togfjalëshit "Akademia e Policisë" të shtohet emërtimi "Arben Zylyftari".

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Akademia e Policisë "Arben Zylyftari" ka mision formimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit të të gjitha niveleve dhe organizimin e realizimin e kërkimeve shkencore në fushën e rendit publik."

c) Në paragrafin e parë të pikës 6, pas fjalës "... krijohet..." shtohet "...dhe funksionon..."

ç) Në paragrafin e katërt të pikës 11, fjalët "...të kenë punuar dy vjet në bazë...", zëvendësohen me "...të kenë punuar 1 (një) vit në bazë..."

d) Pas paragrafit të dytë të pikës 15 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Punonjësit e Policisë së Shtetit, që përfundojnë kurse trajnimi, pajisen me certifikata përkatëse."

2. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.1, datë 16.4.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Zamir Poda	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Ylvi Myrtja	Anëtar
Valentina Kondili	Anëtare
Vladimir Metani	Anëtar
Vladimir Bineri	Anëtar
Evgjeni Sinoimeri	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Shpresa Beça	Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 16.4.2004 morën në shqyrtim çështjen për mosmarrëveshjen e kompetencës së gjykimit në shkallë të dytë, që i përket:

TË PANDEHURIT: EDUARD NDREU

AKUZA: Kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion, parashikuar në nenin 114/b/2 të Kodit Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë Mirditë, me vendimin nr.104, datë 24.11.2003, e ka dënuar të pandehurin për veprën penale për të cilën akuzohet duke caktuar një dënim prej 10 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.5, datë 8.1.2004 ia ka dërguar çështjen Gjykatës së Lartë për t'u shprehur lidhur me kompetencën e gjykimit, me arsyetimin se:

Bazuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, gjykimi i kësaj çështjeje është në kompetencën e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.65, datë 30.1.2004, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.5, datë 8.1.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve asaj gjykate, duke arsyetuar se në rastin konkret nuk ka mosmarrëveshje në lidhje me kompetencën, në kuptim të nenit 89/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.89, datë 17.2.2004 ka vendosur:

Moskompetencën e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Eduard Ndreu dhe dërgimin e çështjes për gjykim gjykatës kompetente, Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda, me vendimin nr.1, datë 1.3.2004 ka vendosur:

Moskompetencën e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Eduard Ndreu, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 114/b/2 të Kodit Penal dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën e Lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me kompetencën.

Kryetari i Gjykatës së Lartë Thimjo Kondi, pasi studioi vendimin nr.1, datë 1.3.2004 të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda vendosi:

Kalimin për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të çështjes për konflikt kompetence midis Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, që i përket të pandehurit Eduard Ndreu, akuzuar për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion në bazë të nenit 114/b/2 të Kodit Penal.

Duke pasur parasysh:

Se midis Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda ka lindur mosmarrëveshja e kompetencës, sepse këto dy gjykata e kuptojnë, interpretojnë dhe zbatojnë në mënyrë të ndryshme nenin 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave të krimeve të rënda";

Se kuptimi, interpretimi dhe zbatimi i ndryshëm i kësaj dispozite në raste të tilla të ngjashme, që do të paraqiten në të ardhmen në këto dy gjykata dhe në gjykata të tjera të apelit, rrezikon të sjellë konfuzion dhe zvarritje të çështjeve të krimeve të rënda dhe mungesë efektiviteti të gjykimit të tyre;

Duke vërejtur se edhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka mendime të ndryshme e të kundërta lidhur me këtë mosmarrëveshje kompetence,

Kryetari i Gjykatës së Lartë ka kërkuar nga Kolegjet e Bashkuara njehsimin e praktikës gjyqësore për problemet e mëposhtme:

1. Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda a mund të shqyrtojë në shkallë të dytë, qoftë edhe përjashtimisht, çështje që janë shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore para datës 1.1.2004, të cilat sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të gjykatave të krimeve të rënda?

2. A ka ndeshje (kolizion) midis rregullimit të përgjithshëm për kompetencën e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda sipas nenit 14/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003?

Në qoftë se do të konkludohet për mospërputhje, kontradikte apo ndeshje midis këtyre dy dispozitave, cila prej tyre merr përparësi në zbatim?

Përgjigjet e pyetjeve të mësipërme duhet të jenë rrjedhojë e interpretimit të nenit 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003, sipas të cilit "Çështjet penale, që do të jenë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë e të apelit deri në ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave për krime të rënda, do të përfundohen nga këto gjykata" dhe të nenit 13/3 (të ndryshuar) të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit "gjykatat e apelit për krimet e rënda shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e krimeve të rënda".

Interpretimet e këtyre dispozitave duhet të pajtohen e harmonizohen me frymën dhe qëllimet e ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 dhe të ndryshimeve përkatëse në Kodin e Procedurës Penale.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Thimjo Kondi dhe Perikli Zaharia, pasi dëgjuan prokurorin Saliko Hajno, që u shpreh për kompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë, e pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

I. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës për gjykimin në shkallë të dytë të çështjes me të pandehur Eduard Ndreu, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 113/b/2 të Kodit Penal, duke iu referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, që përcakton kompetencën lëndore të gjykatave për krime të rënda.

Kjo gjykatë ka bërë në favor të qëndrimit të saj edhe interpretimin e nenit 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave të krimeve të rënda”*, duke arsyetuar se për këtë çështje nuk kishte filluar gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë në kohën kur, sipas ligjit, ka filluar funksionimi i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda (1.1.2004). Regjistrimi i çështjes nuk nënkupton fillimin e procesit të gjykimit.

Sipas nenit 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003, *“Çështjet penale, që do të jenë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit deri në ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave për krime të rënda, do të përfundohen nga këto gjykata”*.

Shtojmë se Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin e saj nuk e ka përmendur fare nenin 13/3 (të ndryshuar) të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit *“Gjykatat e Apelit për Krimet e Rënda shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e krimeve të rënda”*.

II. Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda ka vendosur moskompetencën e saj duke e interpretuar e zbatuar ndryshe nenin 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003, të sipërcituar.

Sipas kësaj gjykate, në kuptim të nenit 11/2, përderisa çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, është hedhur shorti e është bërë shpallja e gjykimit, pavarësisht nëse janë bërë veprime procedurale apo jo, çështja duhet të konsiderohet çështje në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, prandaj kjo gjykatë duhet të konsiderohet kompetente.

Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda arsyeton më tej se edhe çështjet e tjera penale, të cilat duke iu referuar akuzës janë në kompetencë gjykimi të Gjykatës së Krimeve të Rënda, nëse janë gjykuar në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore, do të vazhdojnë të gjykohen në shkallë të dytë nga gjykatat respektive të apeleve, sepse janë në vazhdimësinë normale të procedurës së zakonshme.

Sipas Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, edhe në rastet kur një gjykatë apeli prish një vendim, që aktualisht çështja i takon Gjykatës së Krimeve të Rënda, por është gjykuar në shkallë të parë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çështja do të rishqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë, nga një trup gjykues tjetër i asaj gjykate (nenet 428/ç e 429/1 të Kodit të Procedurës Penale).

Sipas Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, kjo gjykatë është kompetente për të shqyrtuar në shkallë të dytë vetëm çështjet që janë paraqitur për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda (që janë regjistruar për gjykim në atë gjykatë pas datës 1.1.2004).

1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë të drejtë dhe të bazuar në ligj qëndrimin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Kompetenca funksionale e kësaj gjykate përcaktohet nga neni 14/3 i Kodit të Procedurës Penale. Sipas kësaj dispozite kjo gjykatë shqyrton në shkallë të dytë çështjet e gjykuara në shkallë të parë nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Ndërsa dispozita procedurale në fjalë është dispozitë që rregullon kompetencën e gjykimit, neni 11 i ligjit nr.9100, datë 24.7.2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave të krimeve të rënda”* është

dispozita që përcakton kohën e vënies në funksionim të gjykatave të krimeve të rënda. Data e fillimit të veprimtarisë së këtyre gjykatave, sipas përcaktimit që ka bërë ligjvënësi është data 1.1.2004. Nëpërmjet paragrafit të dytë të nenit 11, që është një dispozitë kalimtare, ligjvënësi ka përcaktuar cila do të jetë ecuria e çështjeve të kompetencës lëndore të gjykatave të krimeve të rënda, të përcaktuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, çështje të cilat më datën 1.1.2004 do të jenë në gjykim në gjykatat ekzistuese të shkallës së parë e të apeleve.

Kjo dispozitë përcakton në mënyrë të shprehur se këto çështje do të përfundohen nga këto gjykata. Përsa u përket çështjeve në gjykim në gjykatat e shkallës së parë deri tani nuk ka lindur ndonjë paqartësi, e jo më të jenë mbajtur qëndrime të kundërta. Qëndrime të kundërta, siç parashtrohet më lart, janë mbajtur për “çështjet në gjykim në gjykatat e apelit”. Shtrohet pyetja: *Cilat çështje do të konsiderohen çështje që janë në gjykim në gjykatat e apelit?*

Shumica është e mendimit që çështje të tilla konsiderohen ato çështje, gjykimi i të cilave ka përfunduar në shkallë të parë, d.m.th. ato çështje për të cilat gjykatat e shkallës së parë kanë dalë me një vendim përfundimtar pas shqyrtimit të themelit të tyre, dhe që kundër vendimit është bërë apel.

Kjo është arsyeja që ligjvënësi ka përdorur termin “*çështje në gjykim*” dhe jo “*çështje të regjistruara*”.

Një çështje konsiderohet çështje në gjykim në gjykatën e apelit jo në momentin e veprimit administrativ të regjistrimit të saj në regjistrat e kësaj gjykate, por që në momentin kur është ushtruar apeli kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Po me çështjet që janë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë përpara datës 1.1.2004 çfarë do të bëhet? Neni 11/2 i ligjit nuk lë asnjë dyshim që këto çështje do të vazhdojnë të gjykohen nga këto gjykata deri në përfundimin e tyre. Po kështu, në rast apeli kundër vendimit përfundimtar të shkallës së parë, çështjet do të gjykohen në gjykatat ekzistuese të apelit dhe jo në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda.

Në qoftë se do të pranohej e kundërta, atëherë do të shkelej rregullimi i nenit 14/3 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë, duke parashikuar që Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda shqyrton në shkallë të dytë çështjet e gjykuara nga Gjykata e Krimeve të Rënda, në të njëjtën kohë nënkupton nëpërmjet interpretimit nga e kundërta (ad contrario) se një çështje që nuk është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata e krimeve të rënda, (sepse gjykimi i saj në shkallë të parë ka filluar para datës 1.1.2004), nuk mund të gjykohej në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda. Është kjo arsyeja që ligjvënësi në nenin 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003, që është një dispozitë kalimtare, i ka përfshirë në një formulim të vetëm “*çështjet penale që do të jenë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit deri në ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave për krime të rënda*”, duke iu përmbajtur parimit të vazhdimësisë së gjykimit.

Si përfundim: *Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda nuk mund të shqyrtojë në shkallë të dytë çështje që janë shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore para datës 1.1.2004, të cilat, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë në kompetencë të gjykatave të krimeve të rënda.*

2. Më lart parashtrijmë se problematikat e rregullimit prej nenit 14/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe ajo e nenit 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.07.2003, janë të ndryshme: Ndërsa neni 14/3 i Kodit të Procedurës Penale është një dispozitë procedurale që parashikon kompetencën lëndore të gjykatave të krimeve të rënda, neni 11/2 i ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 është dispozitë kalimtare që siguron vazhdimësinë e gjykimit të çështjeve, të filluara para datës 1.1.2004 në gjykatën e shkallës së parë e mandej në atë të apelit.

Duke qenë dispozita me karakter të ndryshëm e me objekt rregullimi të ndryshëm, nuk bëhet fjalë për mospërputhje, kontradiktë apo ndeshje midis tyre, as për përparësi në zbatim. Ato plotësojnë njëra-tjetrën.

Neni 14/3 i Kodit të Procedurës Penale është një dispozitë procedurale, që rregullon kompetencën lëndore, me karakter të përgjithshëm dhe me fuqi për të ardhmen (pas datës 1.1.2004), ndërsa neni 11/2 i ligjit nr.9110, datë 24.7.2003, si dispozitë kalimtare, ka karakter të përkohshëm dhe të kufizuar deri në përfundimin në shkallë të parë e në apel të çështjeve në proces gjykimi para datës kur fillon zyrtarisht veprimtaria e gjykatave të krimeve të rënda.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës, të neneve 14/c dhe 17/b të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

Të zgjidhin mosmarrëveshjen midis Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për kompetencën e gjykimit të çështjes me të pandehur Eduard Ndreu duke caktuar si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës për gjykimin në shkallë të dytë të çështjes me të pandehur Eduard Ndreu, akuzuar për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion, të parashikuar nga neni 114/b/2 të Kodit Penal, duke iu referuar për këtë nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton kompetencën lëndore të gjykatave për krimet e rënda.

Kjo gjykatë ka interpretuar në favor të qëndrimit të saj nenin 11/2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda”, duke arsyetuar se:

- Për këtë çështje nuk kishte filluar gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë në kohën kur, sipas ligjit, ka filluar funksionimi i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, më 1 janar 2004.

- Regjistrimi i çështjes nuk nënkupton gjykimin e saj.

- Sipas nenit 11/2 të ligjit të mësipërm nr.9110, datë 24.7.2003, “çështjet penale që janë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit deri në ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave për krimet e rënda, do të përfundohen nga këto gjykata.”

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur moskompetencën e saj, duke e interpretuar dhe zbatuar ndryshe nenin 11/2 të ligjit e lartpërmendur nr.9110, datë 24.7.2003.

Sipas kësaj gjykate, në kuptim të nenit 11/2 të ligjit të mësipërm, përderisa çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, pavarësisht nëse janë bërë ose jo veprime procedurale, çështja duhet të konsiderohet çështje në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, prandaj kjo gjykatë duhet të konsiderohet kompetente.

Sipas Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, kjo gjykatë është kompetente për të shqyrtuar në shkallë të dytë vetëm çështjet që janë paraqitur për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (që janë regjistruar për gjykim në atë gjykatë pas datës 1.1.2004).

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me shumicë votash vendosën të zgjidhin mosmarrëveshjen midis gjykatave të mësipërme për kompetencën e gjykimit të kësaj çështjeje, duke caktuar si gjykatë kompetente Gjykatën e Apelit Tiranë.

Qëndrimi i mbajtur nga shumica në këtë rast nuk na duket i drejtë, sepse vjen në kundërshtim me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë ecurinë e gjykimit të çështjeve të kompetencës lëndore të gjykatave për krimet e rënda, të regjistruara, por ende të pagjykuara para datës 1 janar 2004 në gjykatat e apelit. Prandaj parashtrojmë sa vijon:

Në ligjin nr.9085, datë 19.6.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995” Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në nenin 1, me të cilin është ndryshuar pika 3 e nenit 14 të Kodit të Procedurës Penale, është parashikuar **rregulli i përgjithshëm** se: Gjykatat e apelit për krimet e rënda shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykses të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e krimeve të rënda.

Në ligjin e mëvonshëm nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, në nenin 11 që bën fjalë për dispozitat e fundit, pika 1, është parashikuar se: “Gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda fillojnë funksionimin e tyre në datën 1 janar 2004.”

Ndërkohë, ligjvënësi nuk ka lënë jashtë vëmendjes rregullimin ligjor të situatës kalimtare të çështjeve që deri në kohën e fillimit të funksionimit të gjykatave të krimeve të rënda ndodheshin për gjykim pranë gjykatave të zakonshme të shkallës së parë dhe të apelit. Duke mbajtur parasysh këtë situatë, ligjvënësi ka pranuar të bëjë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm që përcakton neni 1 i lartpërmendur i ligjit nr.9085, datë 19.6.2003.

Kështu, në nenin 11 pika 2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, ka parashikuar se: Çështjet penale, që do të jenë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit deri në ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave për krime të rënda, do të përfundohen nga këto gjykata”.

Konflikti për kompetencën që ka lindur midis gjykatave të zakonshme dhe atyre për krime të rënda është i lidhur pikërisht me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e drejtë të kësaj dispozite dhe në varësi të kësaj duhet t’u jepet përgjigje edhe pyetjeve të parashtruara në vendimin për kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga shumica, mendojmë se dispozitat e fundit dhe kalimtare jo pa qëllim bëjnë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit të çështjeve që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të gjykatave të krimeve të rënda.

Ky konkluzion mbështetet në disa argumente:

Së pari, ligjvënësi nuk ka bërë ndonjë ndarje në lidhje me kohën e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe asaj të Apelit për Krime të Rënda. Meqenëse sipas nenit 11 pika 1, të lartpërmendur të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda” është përcaktuar që të dyja këto instance të ndryshme gjyqësore do të fillojnë funksionimin në të njëjtën datë, pra më 1 janar 2004; kjo nënkupton që ligjvënësi ka përcaktuar edhe se me çfarë do të merret Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda duke filluar nga ajo datë.

Pra, shtrohet pyetja: Mos vallë ligjvënësi me funksionim të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, ndryshe me atë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nënkupton vetëm ngritjen (krijimin) dhe jo zhvillimin e gjykimit prej saj?

Përgjigja nga ana jonë do të ishte “jo”, sepse nuk do të ishte e arsyeshme që Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, mbështetur në rregullin e përgjithshëm të lartpërmendur, të rrinte në pritje deri sa t’i vinin për gjykim, nëpërmjet apelit, çështjet e gjykuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pra praktikisht pas disa muajve që të ketë përfunduar gjykimi në atë gjykatë dhe pasi të jetë bërë njoftimi i palës kundërshtare për apelimin e bërë ndaj vendimit përkatës.

Në qoftë se do të pranohej kjo, natyrshëm lind pyetja tjetër:

Përse duhej që këto gjykata të niveleve të ndryshme të ngriheshin dhe të kompletoheshin *me urgjencë* në të njëjtën kohë dhe për rrjedhojë të kërkohej funksionimi i tyre në të njëjtën datë, më 1 janar 2004?

Jo vetëm kaq, por nisur nga fakti që numri i gjyqtarëve të vendit nuk ka ndryshuar, (pra pikërisht Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda u plotësua nga ky numër), si mund të pranohet se ligjvënësi ka lejuar që gjyqtarët e Apelit të Krimeve të Rënda të rrinë në pritje për të gjykuar pas disa muajve, ndërsa gjykatat e zakonshme të apelit, në kushtet e mungesës së krijuar nga lëvizja e gjyqtarëve të tyre në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda, të përballojnë edhe ngarkesën e këtyre gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale i takojnë Gjykatës së Krimeve të Rënda për t’i gjykuar.

Së dyti, ndryshe nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, me çështje penale që do të jenë në gjykim nuk mund të kuptohen edhe çështjet penale që janë regjistruar në sekretarinë e gjykatës, sepse regjistrimi, mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, është një veprim administrativ dhe jo një veprim procedural.

Që çështja të konsiderohet në gjykim nuk mjafton vetëm regjistrimi i saj, por detyrimisht, pas respektimit të radhës së çështjeve të ardhura dhe të regjistruara, caktimi me short i trupit gjykues që do ta gjykojë atë, standard ky i detyrueshëm për funksionimin e pushtetit gjyqësor në mënyrë të pavarur dhe të paanshëm, në zbatim të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEMDNJ) (neni 6).

Përveç kësaj, vetëm pasi procedohet me veprimet paraprahe të gjykimit, sipas nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon urdhërimin për thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre, brenda një afati paraqitjeje jo më të vogël se 10 ditë, çështja konsiderohet se është në gjykim.

Në rast se me çështjet në gjykim do të kuptohen edhe çështjet që vetëm sa janë regjistruar, atëherë duhet të pranohet paradoksi se çështjet që janë regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë në prag të fillimit të vitit 2004 duhet të përfundonin nga kjo gjykatë, pavarësisht se për to nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim procedural dhe pavarësisht se objektivisht ato nuk mund të futeshin në gjykim deri më datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, më 1 janar 2004.

Për rrjedhojë, çështjet e regjistruara në gjykatën e apelit nuk mund të konsiderohen në kuptim të nenit 11 pika 2 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, si çështje në gjykim.

Në këtë vështrim, aq më i papranueshëm është qëndrimi i shumicës se çështje në gjykim në gjykatën e apelit konsiderohen ato çështje, gjykimi i të cilave ka përfunduar në shkallë të parë, d.m.th. ato çështje për të cilat gjykata e shkallës së parë ka dalë me një vendim përfundimtar pas shqyrtimit të themelit të tyre dhe që kundër vendimit është bërë apel.

Ushtrimi i apelit i jep mundësi apeluesit që çështja e tij të shqyrtohet nga gjykata e shkallës së dytë, por cila gjykatë duhet ta shqyrtojë atë kjo nuk varet nga ai, por nga rregulli i vendosur me ligj.

Apeli është i nevojshëm të regjistrohet, por kjo nuk do të thotë se që me regjistrimin e tij si veprim administrativ, çështja konsiderohet se është në gjykim në shkallë të dytë. Nga ana tjetër, vetëm ushtrimi i së drejtës së apelit nuk presupozon se çështja është në gjykim në shkallë të dytë, pa u ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale në zbatim të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e çështjes në këtë shkallë.

Së treti, edhe në ligjin nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, në nenin 5 është përcaktuar kompetenca e gjykatave për krime të rënda. Sipas pikës 1 të këtij ligji është parashikuar se: Gjykata për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda gjykojnë në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë veprat penale të parashikuara nga neni 75 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale.

Por, a ka raste kur gjykata e krimeve të rënda gjykon çështje jo të kompetencës së saj?

Pikërisht në pikën 2 të këtij neni është pranuar përjashtimi nga ky rregull i përgjithshëm.

Sipas kësaj pike, kur gjatë gjyimit ndryshohet cilësimi ligjor i veprës penale dhe për këtë shkak kompetente është një gjykatë tjetër, gjykimi vazhdon dhe përfundohet nga gjykata e krimeve të rënda, duke zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Pra, vetë ligjvënësi ka pranuar se në raste të veçanta këto gjykata nuk mund të gjykojnë vetëm veprat penale të parashikuara nga neni 75, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale.

Po të qëndronte strikt në parimin e vazhdimësisë së gjyimit të atyre çështjeve që janë në kompetencë të gjykatës së krimeve të rënda, atëherë ligjvënësi nuk kishte përse në këtë rast ta jepte këtë zgjidhje, “duke rënduar pozitën e të pandehurit”, siç përmend shumica në favor të qëndrimit të saj për rastin në gjykim.

Siç shihet, edhe në këtë dispozitë ligjvënësi ka pranuar përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm.

Me këtë rast i jepet përgjigje edhe pyetjes nr.3 të paraqitur në vendimin për kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kështu, kur ligji i mëvonshëm parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm për të rregulluar një gjendje kalimtare të gjyimit të çështjeve, atëherë nuk ka përse ky përjashtim të merret dhe të kuptohet se bie ndesh me rregullin e vendosur nga ligjvënësi në nenin 75 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me kompetencat e gjykatës për krime të rënda.

Së katërti, duke mbajtur parasysh statusin e gjyqtarëve të gjykatës së krimeve të rënda, që lidhet jo vetëm me përzgjedhjen, por edhe me masat e sigurimit dhe trajtimit të tyre, si dhe përbërjen e trupit gjykues të kësaj gjykate prej pesë gjyqtarësh të kësaj kategorie, ky është një tjetër argument që mbështet qëndrimin e pakicës se, veprat penale të parashikuara nga neni 75 shkronja

“a” të Kodit të Procedurës Penale, duhet të gjykohen nga kjo gjykatë apeli, pavarësisht së në shkallë të parë janë gjykuar nga gjykata e zakonshme. Kjo është një garanci me tepër për të pandehurit dhe jo rëndim i pozitës së tyre.

Në mbështetje të argumenteve të mësipërme dhe duke iu përgjigjur pyetjes nr.2 të parashtruar në vendimin për kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkludojmë se:

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda mund të shqyrtojë në fazën kalimtare çështje që janë shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore para datës 1.1.2004 dhe që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë në kompetencë të gjykatave të krimeve të rënda, në përmbushje të qëllimit për të cilin ato janë krijuar.

Përgjigja e pyetjes nr.3 është e lidhur me sa më sipër.

Pra, në rastet kur një gjykatë apeli (jo e krimeve të rënda), e cila është duke gjykuar një çështje të kompetencës së gjykatës për krime të rënda, e prish vendimin dhe vendos dërgimin e çështjes për rishqyrtim, çështjen duhet t’ia dërgojë gjykatës për krime të rënda, për shkak se në këtë rast, nga njëra anë gjykimi do të konsiderohej se fillonte nga e para, me tjetër trup gjykues dhe nga ana tjetër kjo do të ishte në përmbushje të qëllimit për të cilin këto gjykata janë krijuar.

Kështu, sipas nenit 1 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda” synimi i këtij ligji është jo vetëm rritja e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, por edhe përmirësimi i cilësisë së gjykimit të tyre.

Në përfundim, mendojmë se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të zgjidhur mosmarrëveshjen midis Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda lidhur me kompetencën e gjykimit të çështjes me të pandehur Eduard Ndreu, akuzuar për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion, në bazë të nenit 114/b/2 të Kodit Penal, duhet të caktojë si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Anëtarë: Perikli Zaharia, Shpresa Beça, Kristaq Ngjela

MENDIMI I PAKICËS KUNDËR

Në lidhje me vendimin nr.1, datë 16.4.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nuk jam dakord me vendimin nr.1, datë 16.4.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, jo thjesht për sa i takon zgjidhjes përfundimtare që i është bërë çështjes objekt gjykimi dhe përcaktimeve unifikuese (sentencave) që janë pranuar prej saj, por sidomos për faktin që kjo çështje është tërhequr me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për t’u gjykuar nga këto Kolegje, për arsye të mëposhtme:

Në lidhje me gjykimin në Kolegjet e Bashkuara, në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, bëhet fjalë në Kushtetutë, në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë".

Konkretisht, në pikën 2 të nenit 141 të Kushtetutës thuhet: "**Për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore**, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore".

Në pikën 1 të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale thuhet:

"Kur lind nevoja **për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore**, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të ardhura për shqyrtim në Kolegjin Penal, kurse në pikën 2 të tij thuhet: "Tërheqja e çështjeve bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Penal".

Në shkronjën "c" të nenit 14 të ligjit organik të Gjykatës së Lartë, në të cilin përcaktohen çështjet që gjykohen në Kolegjet e Bashkuara, thuhet: "**Kërkesat për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore**".

Siç shihet, rastet në të cilat kolegjeve të veçanta të Gjykatës së Lartë apo dhe kryetarit të kësaj gjykate, i lind e drejta për të tërhequr çështje në gjykim në Kolegjet e Bashkuara, janë qartësisht të përcaktuara në mënyrë të tillë që nuk lihet shteg për rritjen e numrit të tyre (rasteve). Ato janë dy: a) **njehsimi** dhe b) **ndryshimi i praktikës gjyqësore**.

Po kështu, nga vetë formulimi i dispozitave të përmendura, del fare qartë se, nevoja për njehsim ose ndryshim është e kushtëzuar domosdoshmërisht **me ekzistencën e praktikës gjyqësore**, në lidhje me çështje të ndryshme që kanë pasur për zgjidhje të njëjtin objekt gjykimi. Në kuptimin që, **për të pasur praktikë gjyqësore**, numri i çështjeve të gjykuara më parë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ose nga gjykatat e shkallëve të tjera të gjykimit nuk ka rëndësi, mjafton që të jenë dhënë më parë disa vendime të formës së prerë për çështje analoge.

Ndryshe nga sa më sipër, në rastin objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara, kjo ishte çështja e parë që erdhi për t'u gjykuar, jo vetëm në Gjykatën e Lartë, por edhe në vetë dy gjykatat e apelit (Gjykata e Apelit Tiranë dhe ajo për Krime të Rënda) midis të cilave ka lindur mosmarrëveshja e kompetencës.

Në këto kushte, megjithëse zgjidhja e shpejtë në përputhje me kërkesat e ligjit e kësaj mosmarrëveshjeje, mund të ndikojë në evadimin e çështjeve të mbartura, që për shkak të keqkuptimeve apo keqinterpretimit të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe pikës 2 të dispozitës së nenit 11 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda", vazhdojnë të qëndrojnë pezull, nuk i lind e drejta Kryetarit të Gjykatës së Lartë që të tërhiqte çështjen nga Kolegji Penal dhe ta dërgonte për gjykim në Kolegjet e Bashkuara.

Investimi pa vend, në kundërshtim me ligjin, sikurse në rastin konkret, i Kolegjeve të Bashkuara për të zgjidhur nevoja të karakterit organizativ midis gjykatave, mendoj se përbën precedent negativ me pasoja të dëmshme për pavarësinë e gjykatave në të ardhmen.

Besoj se kjo duhet të ketë qenë edhe arsyeja që, në ndryshimet që iu bënë dispozitës së nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, i është hequr e drejta Kryetarit të Gjykatës së Lartë për të dërguar në Kolegjet e Bashkuara çështje, të cilat, sipas formulimit të mëparshëm të kësaj dispozite, konsideroheshin **me rëndësi të veçantë**.

Për arsyet e parashtruara më lart, jam i mendimit që kjo çështje nuk duhej të vazhdonte të gjykohej nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por të dërgohej për shqyrtim në Kolegjin Penal të saj.

Spiro Spiro

VENDIM

Nr.10, datë 24.3.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Zamir Poda	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Bashkim Caka	Anëtar
Natasha Sheshi	Anëtare
Perikli Zaharia	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Ylvi Myrtja	Anëtar
Vladimir Metani	Anëtar
Evgjeni Sinoimeri	Anëtare
Irma Bala	Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 24.3.2004 morën në shqyrtim çështjen civile, me palë:

PADITËS: SHOQËRIA "EDEN" sh.a., në mungesë.

TË PADITUR: ALBTELEKOM sh.a., përfaqësuar nga juristja L. Himçi dhe Avokati i Shtetit Petrit Myftari.

OBJEKTI: Përmbushje e detyrimeve kontraktore, në bazë të kontratës së datës 13.1.2003.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e ndërmjetëm nr.3537 akti, datë 15.5.2003, ka vendosur:

- Marrjen e masës provizore për sigurimin e objektit të padisë, duke urdhëruar shoqërinë ALBTELEKOM sh.a. që t'i lirojë menjëherë shoqërisë "EDEN" sh.a. sinjalin e bllokuar nga ana e tij, deri në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.121, datë 17.7.2003, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.3537 akti, datë 15.5.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër këtyre vendimeve ka ushtruar rekurs pala e paditur ALBTELEKOM sh.a., duke parashtruar sa më poshtë:

- Trafiku i munguar në periudhën shtator 2002 - mars 2003, referuar pikës 12.3 të kontratës, rezulton të jetë 4.167.305 minuta, si pasojë e devijimit të trafikut kombëtar dhe ndërkombëtar, përveç lidhjeve të dhëna nga ALBTELEKOM sh.a. Nga kjo diferencë, shoqërisë Albtelekom sh.a. i është shkaktuar një dëm prej 260 milion lekë.

- Albtelekom sh.a. e ka ndërprerë sistemin bazuar në nenet 12.3 dhe 13.3 të kontratës, të cilat janë keqinterpretuar dhe keqzbatuar nga gjykatat.

- (Neni 12.3: "Sipas ligjit në fuqi OSHPK (EDEN sh.a.) nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë apo rrethanë të përdorë lidhjet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, për të vijuar trafikun kombëtar/ndërkombëtar, përveç lidhjeve të dhëna nga ALBTELEKOM sh.a.").

- Neni 13.3: "Në rast se konstatohet dhe vërtetohet në bazë faktesh shkelje përsa është përcaktuar në pikën 12.3, do të bëhet ndërprerja e sistemit në rrjetet e Albtelekomit të vëna në shfrytëzim sipas objektit të kësaj kontrate".

Kryetari i Gjykatës së Lartë, duke qenë se në praktikën gjyqësore ka vërejtur raste të qëndrimeve të ndryshme lidhur me kuptimin e masave për sigurimin e padisë, llojet e tyre, e mënyrën e dhënies së tyre, duke marrë shkas nga kjo çështje, me vendimin e datës 9.2.2004 ka vendosur: *Shqyrtimin në Kolegje të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për efekt të njësimi të praktikës gjyqësore, të çështjes civile me paditës shoqëria "Eden" sh.a., të paditur Albtelekom sh.a., lidhur me rekursin kundër masës së sigurimit të padisë, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.*

Në funksion të njësimi të praktikës gjyqësore, shtrohen problemet e mëposhtme:

1. Sipas nenit 206 të Kodit të Procedurës Civile, "Sigurimi i padisë bëhet:

b) me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit.

Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë në disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se ata të padisë.

....."

Duke iu referuar dispozitës së mësipërme, shtrohen pyetjet:

1) Cilat janë disa nga "masat e tjera të përshtatshme" që merren për sigurimin e padisë, sipas kësaj dispozite?

2) Cili është kuptimi i masës provizore të pezullimit të ekzekutimit dhe në cilat raste merret kjo masë?

3) Masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 206 pika "b" të Kodit të Procedurës Civile, a duhet të kushtrëzohet kurdoherë nga një objekt material i përcaktuar, apo i përcaktueshëm i padisë.

4) Në një çështje civile ku kërkohet përmbushja forcërisht e një detyrimi kontraktor për të kryer apo moskryer një veprim të caktuar, a mund të merren masat e sigurimit të padisë, sipas pikës "b" të nenit 206 të Kodit të Procedurës Civile?

5) Në qoftë se njëra palë e një kontrate kryen një veprim, që përbën zgjidhje në mënyrë të njëanëshme të kontratës, gjykata, që shqyrton konfliktin, a ka të drejtë të marrë si masë sigurimi të padisë urdhërimin për rilidhjen e kontratës? A mund të rivendoset me masë sigurimi gjendja e mëparshme e marrëdhënies kontraktore që ka ekzistuar para lindjes së konfliktit?

6) A mund të vendoset me anë të një mase të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri?

E thënë ndryshe, masa e sigurimit që vendoset nga gjykata, a mund të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërimit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë?

2. Cila duhet të jetë mënyra e shqyrtimit të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, përmbajtja dhe mënyra e arsyetimit të një vendimi të dhënë për të, me qëllim që të shmangët perceptimi që gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel, apo që me veprimet e saj ndikon në zvarritjen e gjykimit të çështjes në themel?

3. Pezullimi i zbatimit të një akti administrativ, sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Civile, a përbën një masë për sigurimin e padisë në kuptim të nenit 206 pika "b" të Kodit të Procedurës Civile?

A ka veçori dalluese midis masave për sigurimin e padisë në një çështje civile të mirëfilltë, nga njëra anë dhe masës për pezullimin e zbatimit të një akti administrativ, ligjshmëria e të cilit është objekt shqyrtimi gjyqësor?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Thimjo Kondi e Zamir Poda, përfaqësuesen e palës së paditur dhe Avokatin e Shtetit që kërkuan prishjen e të dy vendimeve dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë, dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi i ndërmjetëm nr.3537 akti, datë 15.5.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur marrja e masës provizore për sigurimin e objektit të padisë, duke urdhëruar shoqërinë ALBTELEKOM sh.a. që t'i lirojë menjëherë shoqërisë EDEN sh.a. sinjalin e bllokuar nga ana e tij, deri në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe vendimi nr.121, datë 17.7.2003 i Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i mësipërm, janë të pabazuar në ligj, prandaj duhet të prishen dhe përfundimisht të hiqet masa e përkohshme.

Nga materialet e gjykimit në shkallë të parë e në apel rezulton si më poshtë:

Pala paditëse, shoqëria EDEN sh.a., pasi është pajisur nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve me licencën për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve nr.405/1001, datë 4.10.2002, ka lidhur me palën e paditur ALBTELEKOM sh.a. një kontratë me anën e së cilës ALBTELEKOM sh.a. vë në dispozicion sistemet e mjeteve të tij të telekomunikacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ofruesi i shërbimeve me kartë të parapaguar (Shoqëria EDEN sh.a.) shfrytëzon këto sisteme për të ofruar sistemin me kartë të parapaguar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë që përfshin licenca.

Në kontratën e datës 13.1.2003 janë parashikuar hollësisht objekti, trafiku dhe matjet e tij, rakordimi i trafikut, tarifat, faturimi, pagesa, parimet e rrugëzimit, numeracioni, interkoneksioni, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe sanksionet përkatëse.

Konkretisht, në nenin 12.3 të kontratës parashikohet se: "Sipas ligjit në fuqi, OSHPK (EDEN sh.a.) nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë apo rrethanë të përdorë lidhjet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për të vijuar trafikun kombëtar/ndërkombëtar, përveç lidhjeve të dhëna nga ALBTELEKOM sh.a.".

Në nenin 13.3 të kontratës parashikohet se "Në rast se konstatohet dhe vërtetohet në bazë faktesh shkelje për sa është përcaktuar në pikën 12.3, do të bëhet ndërprerja e sistemit në rrjetet e Albtelekomit të vëna në shfrytëzim sipas objektit të kësaj kontrate".

Konflikti midis palëve ka lindur pikërisht se ALBTELEKOM sh.a., duke pretenduar se është shkelur nga pala kontraktuese EDEN sh.a. neni 12.3 i kontratës duke përdorur lidhje të tjera

kombëtare dhe ndërkombëtare, përveç lidhjeve të dhëna nga ALBTELEKOM, në zbatim të nenit 13.3 të kontratës, ka bërë ndërprerjet e sistemit të shoqërisë EDEN sh.a., në rrjetet e ALBTELEKOM sh.a., të vëna në shfrytëzim sipas objektivit të kësaj kontrate.

Pala paditëse EDEN sh.a, duke pretenduar së ndërprerja e sistemit të saj në rrjetet e ALBTELEKOM-it është e pabazuar në ligj dhe në kontratën e lidhur midis palëve, nëpërmjet padisë që është në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, ka kërkuar:

1. Detyrimin e ALBTELEKOM sh.a. të përmbushë detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata e datës 13.1.2003.

2. Shpërblimin e dëmit ekonomik e moral të shkaktuar nga ndërprerja arbitrare e sinjalit.

Pala paditëse ka kërkuar gjithashtu marrjen e menjëhershme të masës për sigurimin e padisë nëpërmjet urdhërimit të ALBTELEKOM sh.a. që të lirojë menjëherë sinjalin e bllokuar nga ana e tij në drejtim të EDEN sh.a., duke iu referuar neneve 204, 206/b, 324 etj. të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se paditësi nuk ka marrë nga pala e paditur asnjë përgjigje zyrtare për ndërprerjen e njëanëshme të kontratës, se për ndërprerjen e sinjalit nuk është njoftuar dhe nuk dihen shkaqet e ndërprerjes, nisur nga fakti që ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit mund të bëhet i pamundur ose i vështirë në përfundim të këtij gjykimi, ka vendosur marrjen e masës provizore për sigurimin e objektivit të padisë, duke urdhëruar shoqërinë ALBTELEKOM sh.a. që t'i lirojë shoqërisë EDEN sh.a. sinjalin e bllokuar deri në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje.

Gjykata e Apelit Tiranë e ka lënë në fuqi vendimin e ndërmjetëm për masën e përkohshme, duke arsyetuar, ndër të tjera, se ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të jetë i pamundur të realizohet. Prerja e sinjaleve e realizuar nga pala e paditur është bërë në mënyrë të menjëhershme pa negociuar me paditësin dhe pa i vënë në dukje këtij të fundit shkaqet e ndërprerjes, duke i sjellë një dëm ekonomik e moral.

Gjykata e apelit arsyeton më tej se: *“Pretendimi i të paditurit se paditësi ka shkelur kushtet e nenit 12.3 e 13.3 të kontratës janë të pabazuara. I padituri nuk ka provuar të konstatojë që të ketë bërë sondazhe për të vërtetuar se paditësi ka përdorur linja të tjera private për të devijuar trafikun kombëtar e ndërkombëtar të dhënë nga ALBTELEKOM-i. Vetëm në qoftë se pala e paditur do të konstatonte apo vërtetonte me fakte shkeljet (çka është e mundur të realizohet) sipas pikës 12.3 të kontratës, të paditurit i lindte e drejta të ndërpriste linjën në dëm të paditësit.”.*

Duke iu referuar përmbajtjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e sidomos të gjykatës së apelit për masën e përkohshme të sigurimit të padisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se nëpërmjet këtyre vendimeve janë nxjerrë edhe përfundime që i përkasin shqyrtimit dhe zgjidhjes së çështjes në themel.

Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel.

Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi, sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim.

Në radhë të parë gjykata duhet të vlerësojë nëse masa e përkohshme për sigurimin e padisë e kërkuar nga paditësi është në përshtatje me kërkesat e nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, në veçanti nëse ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit eventual për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Në rastin në shqyrtim, duke u ndodhur përpara një mosmarrëveshjeje kontraktore, si masë e përshtatshme e përkohshme për sigurimin e padisë mund të ishte sekuestrimi i llogarive të palës së paditur, bazuar në nenin 206/a të Kodit të Procedurës Civile.

Një nga kërkimet e palës paditëse është detyrimi i palës së paditur të përmbushë detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata e datës 13.1.2003. Sipas pikës 12.4 të kontratës, *“Albtelekom përgjigjet për t'i siguruar OSHKP (palës paditëse) akses të vazhdueshëm 24 në 24 orë me të drejtë ndërprerjeje të sistemit vetëm për shkelje të parashikuara në pikën 13.2 dhe 13.3 të kontratës”.*

Pra, pretendimi i paditësit është se pala e paditur ka shkelur kontratën, duke ndërprerë sistemin pa ndonjë shkak të përligjur dhe kërkimi i tij (paditësit) është detyrimi i palës së paditur për përmbushjen e detyrimit kontraktor për lidhjen e sistemit të paditësit me rrjetin e të paditurit, gjë që mund të realizohet në përfundim të shqyrtimit të çështjes në themel. Të njëjtën gjë paditësi ka kërkuar ta realizojë menjëherë, pa përfunduar gjykimi i çështjes, nëpërmjet marrjes së masës së përkohshme të sigurimit të padisë.

Lidhja e sistemit, që është ndërprerë në mënyrë të njëanëshme, është kërkim i paditësit kundrejt të paditurit, që kërkohet të realizohet nëpërmjet padisë me një vendim të formës së prerë të gjykatës. Me fjalë të tjera, paditësi ka kërkuar të rivendoset gjyqësisht gjendja e mëparshme e marrëdhënies kontraktore që ka ekzistuar para lindjes së konfliktit. Por, kjo gjendje juridike nuk mund të rivendoset paraprakisht me masë të përkohshme të sigurimit të padisë. Ndryshe nuk do të kishte kuptim vazhdimi i gjyqimit të çështjes për këtë kërkim, sepse ajo do të ishte e paragjykuar dhe e paravendosur.

Si përfundim, *masa e sigurimit nuk mund të merret për t'u rivendosur gjendja e mëparshme e marrëdhënies kontraktore midis palëve, ashtu si ka ekzistuar para lindjes së mosmarrëveshjes. Në një këndvështrim më të gjerë, në qoftë se në kontratën e lidhur midis palëve është parashikuar që, për shkaqe të caktuara, njëra palë do të ketë të drejtë ta zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, (sikurse është parashikuar në nenin 13.3 të kontratës), gjykata që shqyrtton konfliktin nuk ka të drejtë të urdhërojë paraprakisht rilidhjen e kontratës. Urdhërimi i rilidhjes së kontratës nuk mund të konsiderohet si masë e përkohshme për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206/b të Kodit të Procedurës Civile, rilidhja e kontratës mund të urdhërohet vetëm me vendim përfundimtar të gjykatës për zgjidhjen e çështjes në themel.*

Përfundimet e mësipërme nuk kanë vlerë vetëm për konfliktet kontraktore, por për të gjitha çështjet gjyqësore në të cilët kërkohet rivendosja e të drejtave civile të cenuara, të shkelura apo të mohuara, si dhe shpërblimi i dëmeve eventuale. *Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E thënë ndryshe, masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërkit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë.*

Sipas nenit 206 të Kodit të Procedurës Civile, “Sigurimi i padisë bëhet:

- a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të kredive të debitorit;
- b) me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit.

.....”

Masa kryesore e përkohshme e sigurimit të padisë është ajo e parashikuar në pikën “a” të dispozitës së mësipërme: sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe i kredive të debitorit. Kjo quhet sekuestro konservative. Sekuestroja konservative mund të vendoset në qoftë se gjyqtari (gjykata) krijon bindje se kreditori (paditësi) ka motiv për t'u shqetësuar se debitori (i padituri), përpara se të merret një vendim gjyqësor që të vërtetojë të drejtën e tij dhe të urdhërojë rivendosjen e saj apo shpërblimin e dëmit eventual, do të zvogëlojë apo do të fshehë pasurinë e tij.

Sekuestrimi i sendeve të paluajtshme bëhet duke urdhëruar Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që të ndalojë shitjen, dhurimin apo çdo lloj disponimi të tyre. Sekuestrimi i sendeve të luajtshme bëhet duke ia dhënë ato në ruajtje një personi të tretë, fizik apo juridik.

Sekuestrimi i të hollave apo kredive bëhet duke urdhëruar depozitimin e tyre në një institucion bankar dhe ngrirjen e tyre, apo ngrirjen e depozitave bankare, të llogarive rrjedhëse etj. të debitorit.

Pas vendosjes së sekuestros konservative, çdo veprim juridik për disponimin e sendeve apo kredive të sekuestruara është i pavlefshëm dhe ngarkon me përgjegjësi personin e tretë që i janë lënë në ruajtje sendet apo kreditë.

Në përfundim të gjyqimit, në qoftë se gjykata provon se sendet e sekuestruara janë në pronësi të kreditorit d.m.th. pranon padinë e kërkit të tyre, atëherë ajo urdhëron që ato t'i kalojnë kreditorit.

Në rastin e pranimit të një padie detyrimi në të holla apo shpërblimi dëmi, atëherë sekuestroja konservative kthehet në sekuestro ekzekutive dhe sendet e sekuestruara i nënshtrohen procesit të ekzekutimit të detyrueshëm.

Llojet e tjera të masave të sigurimit të padisë, sipas parashikimit të pikës “b” të nenit 206 të Kodit të Procedurës Civile, përveç masës së pezullimit të ekzekutimit, janë të papërcaktuara në mënyrë konkrete. Kjo do të thotë se gjykata, rast pas rasti, ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit.

Në rastin në shqyrtim, masa që gjykata e ka quajtur masë sigurimi të padisë (*urdhërimi për lidhjen e sinjalit të ndërprerë deri në përfundim të gjykimit të çështjes*) nuk mund të konsiderohet e tillë jo vetëm për arsyet e parashtruara e të argumentuara më lart, por edhe sepse kjo masë, e vendosur paraprakisht nga gjykata, nga njëra anë i siguron paditësit një mbrojtje paraprake që nuk e parashikon kontrata e lidhur midis palëve dhe, nga ana tjetër, mund të dëmtojë padrejtësisht dhe rëndë të drejtat dhe interesat e të paditurit, në qoftë se përfundimi i gjykimit do të konkludojë se i padituri ka kryer një veprim të bazuar në ligj dhe në kontratën e lidhur midis palëve.

Interesat e të paditurit dëmtohen sidomos kur gjykata e zvarrit gjykimin pambarimisht, ndërsa për paditësin vazhdon gjendja e mëparshme e veprimeve të tij, të cilat në përfundim të gjykimit mund të rezultojnë të paligjshme.

Një masë e tillë e vendosur nga gjykata, që konsiston në rivendosjen e një lidhjeje të ndërprerë në mënyrë të njëanshme apo arbitrarë, do të konsiderohej e ligjshme e do të përfshihej në masat e tjera të përshtatshme të sigurimit të padisë, në qoftë se do të parashikohej në nënyrë taksative në ligj dhe/ose do të rezultonte nga vetë natyra e marrëdhënies juridike (*e kontratës së lidhur midis palëve*).

Të tilla janë p.sh. disa kontrata furnizimi me lëndë të parë apo energji, të ndërruar nga njëra-tjetra, që sigurojnë funksionimin e vazhdueshëm e të pandërprerë të një veprimtarie industriale, të një procesi teknologjik të caktuar, të një veprimtarie të vendosur për mbrojtjen e jetës e të shëndetit të njerëzve etj., ndërprerja e të cilave do të shkaktonte dëme të pallogaritshme e të pariparueshme, shkatërrime të mëdha apo katastrofa.

Përsa u përket masave të tjera të përshtatshme “që merren për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206 pika “b” të Kodit të Procedurës Civile, duhet të kemi parasysh gjithashtu se edhe ato duhet të kushtëzohen kurdoherë nga një objekt material i përcaktuar, apo i përcaktueshëm, i padisë. Është kjo arsyeja që gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmone për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë. Në rastin në shqyrtim, gjykata që në fillim duhej të kish kërkuar nga paditësi që të përcaktonte objektin e padisë përse i përket kërkit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ndërprerja e lidhjes së rrjetit (*ndërprerja e sinjalit*). Përcaktimi i objektit të padisë shërben si bazë fillestare për të vendosur lidhur me masat e sigurimit.

Ndër masat e tjera të përshtatshme për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206/”b” të Kodi i Procedurës Civile, përfshihet shprehimisht edhe *“pezullimi i ekzekutimit”*. Kjo dispozitë përmban në vetvete një paqartësi lidhur me aktin apo veprimin, ekzekutimi i të cilit kërkohet të pezullohet. Në këto raste kemi të bëjmë, si rregull, me padi në të cilat paditësi kërkon detyrimin e të paditurit të mos vërë në ekzekutim një akt nëpërmjet të cilit tërheq përfitime.

Në këto raste marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padisë synon *“ta mbajë gjendjen ashtu siç është”*, apo *“të ngrirë”*, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila, për vetë natyrën e çështjes, duhet të realizohet nëpërmjet një procedure të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithsesi, që të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor.

Masa e përkohshme për pezullimin e ekzekutimit duhet të shoqërohet, si rregull, me detyrimin e palës tjetër për dhënien e një garancie pasurore për të mbuluar dëmet që mund t'i shkaktohen të paditurit nga pezullimi i ekzekutimit.

Në praktikën e gjykatave të shkallës së parë dhe të palëve vërehet shpesh që ato konsiderojnë si masë sigurimi të padisë edhe pezullimin e zbatimit të një akti administrativ të

kundërshtuar në gjykatë, duke iu referuar, krahas nenit 329 të Kodit të Procedurës Civile, edhe nenit 202 e 206/”b” të këtij Kodi.

Këto probleme nuk janë objekt shqyrtimi në këtë çështje. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të mendimit se kërkesa për kundërshtimin në gjykatë të një akti administrativ nuk ka tiparet e një padie civile të mirëfilltë, prandaj edhe pezullimi i zbatimit të aktit administrativ nga ana e gjykatës, kur e lejon ligji, nuk duhet të konsiderohet si një masë e përkohshme për sigurimin e padisë në kuptim të nenit 206 pika “b” të Kodit të Procedurës Civile. Prandaj, referenca në këtë rast edhe në nenin 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile nuk është e saktë.

Konsiderimi në këto raste i masës së pezullimit të zbatimit të aktit administrativ si masë e përkohshme e sigurimit të padisë e shoqëruar me zvarritje të gjykimit të çështjes, rrezikon të çojë për palën e paditur në shkaktimin e dëmeve të mëdha e të pariparueshme, në eventualitet e rrëzimit të padisë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës, të nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile dhe të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr.121, datë 17.7.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.3537 akti, datë 15.5.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe anulimin e masës së përkohshme të sigurimit të padisë të vendosur në favor të palës paditëse, shoqërisë EDEN sh.a.
2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën "Për shtesë shpronësimi që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Balldre-Piraj, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër".

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve".

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU: LEZHE

Lista e pronareve qe shpronosen per shkak te ndertimit te segmentit rrugor Lezhe - Shkoder seksioni trete Balldre - Piraj

Lloji i pasurise se paluajtshme: Toke are,kulture bujqesore nr. (1-11)

Nr.Emri	Pronar		Fshati	Nr.	Sip. shpr. Tot. m2	VKM Nr.246 24.4.2003	Diff.sip. Are m2	Cmimi lek/m2	Vlera leke	Kult.bujq ne leke	Vlera Totale leke	Shenime
	Atesia	Mbiemri										
1	Nikoll	Ndue	Nikolla	Kallmet	209/24	1145	1060	85	900	76500	1360	Zone kadastrale e paregjistruar
2	Tom	Jak	Kola		209/23	1188	969	219	900	197100	3504	Zone kadastrale e paregjistruar
3	Gjin	Jak	Kola		209/22	802	760	42	900	37800	672	Zone kadastrale e paregjistruar
4	Rrok	Mark	Skandaj	Baqel	2/3	1864	1848	16	900	14400	256	
5	Sander	Mark	Skandaj		2/2	1028	924	104	900	93600	1664	
6	Mark	Dode	Skandaj		2/1	944	924	20	900	18000	320	
7	Zef	Nikoll	Suli	Gjader	79/3	1716	1584	132	900	118800	2112	Plotesim dokumentacioni
8	Nikoll	Zef	Suli		79/4	794	726	68	900	61200	1088	Plotesim dokumentacioni
9	Ndoc	Mark	Shtjefni	Dajc	277/1	4952	4752	200	900	180000	3200	Plotesim dokumentacioni
10	Vlash	Ndoc	Shtjefni		277/5	200		200	900	180000	3200	Plotesim dokumentacioni
11	Dila	Pjeter	Miloti		165/19	1978	1458	520	900	468000	8320	Nr. 224 ne VKM Nr 246
				Shuma		16611	15005	1606	900	1445400	25696	1471096

Mbyllet me numer rendor 11 njembdhjete

Shenim; Brenda afatit ligjor 15 dite pas publikimit, te gjitha pronaret qe jane me shenim, plotesim dokumentacioni, te paraqesin dokumentacionin e nevojshem ligjor (certifikate pronesie,harte treguese e karte) te noterizuara,prane sektorit te Shproneseve ne Ministrine e Transportit dhe Telekomunikacionit

SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën "Për shtesë shpronësimi që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Piraj-Kthesa Vau i Dejës, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër".

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve".

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU: LEZHE dhe SHKODER

Lista e pronareve qe shproneshohen per shkak te ndertimit
te segmentit rrugor Lezhe - Shkoder seksioni i katert Piraj - Kthesa Vau i Dejes

Lloji i pasurise se paluajtshme: Toke are - Pentore, Pyje - Kullote, Ndertese,kult.buiq. dhe dru frutore Nr. 1-58

Nr.	Pronari		Nr. i pas.	VKM nr.334	Sip. Are/P m2	Cnimi lek/m2	Vlera ne lek	Dif. Sip. Pyje-kult. m2	Cnimi lek/m2	Vlera ne lek	Ndert. sip. m2	Cnimi lek/m2	Vlera ne lek	Kult.buiq. Leke	Vlera dru-frut leke	Totali ne leke	Shërtime
	Emri	Atesia	Mbhenuri														
1	i paidentifikuar		135	222	105	900	94500							1680		96180	Pretendim pronësie
2	Frrok	Gjon	Ndreca	133/15	510	90	81000							1440	506000	588440	Certifikate pronësie
3	Xhevair	Ismail	Sela	133/19	122	120	108000							1920		109920	Certifikate pronësie
4	Lazer	Luk	Marku	132/13	2469	190	171000							3040		174040	Certifikate pronësie
5	Ejell	Gjon	Shijefini	120/4	334	90	81000							1440		82440	munjon kartela e prones.
6	Jak	Dode	Rrazhani	120/5	2319	90	81000							1440		82440	munjon kartela e prones.
7	Gani	Mustaf	Shahini	47/4	237	60	54000							960		54960	Certifikate pronësie
8	Shaban	Hider	Shahini	47/3	29	80	72000							1280		73280	munjon kartela e prones.
9	Hider	Mustaf	Shahini	48/8	128	34	30600							544		31144	munjon kartela e prones.
10	Shaban	Hider	Shahini	48/7	207	45	40500							720		41220	munjon kartela e prones.
11	Xhevair	Daut	Shahini	48/6	266	58	52200							928		53128	munjon kartela e prones.
12	Asllan	Zenel	Dani	42/20							156/78	24738	5788692		344000	6132692	Certifikate pronësie
13	Naim	Faik	Dani	1/17		646	581400							10336		591736	munjon kartela e prones.
14	Pjeter	Ndue	Doda	5/2							150	80%amort.	742140			742140	Certifikate pronësie
15	Ded	Ndue	Doda	5/3							108	80%amort.	534341			534341	Certifikate pronësie
16	Hasan	Hamz	Hamzi	1/14	1378			2022	300	606600						606600	munjon kartela e prones.
17	Ismail	Hamz	Hamzi	1/14	1378			2022	300	606600						606600	munjon kartela e prones.
18	Zade	Hamz	Hamzi	1/14	1378			2022	300	606600						606600	munjon kartela e prones.
19	Bice		Zagani	425/3				840	300	252000						252000	Vertetim hipotekor
20	Mejreme		Zagani	425/3				840	300	252000						252000	Vertetim hipotekor
21	Sofije		Zagani	425/3				840	300	252000						252000	Vertetim hipotekor
22	Mimire		Zagani	425/3				840	300	252000						252000	Vertetim hipotekor

[illegible]

Shenim; Brenda afatit ligjor 15 dite pas publikimit, te gjitha pronaret qe jane me shenim, plotesim dokumentacioni,mungese karteles pronesie apo vertetim hipotekor, te paraqesin dokument. e nevojshem ligjor (certif. pron, harte treg e karteles) te noterizuara, prane sekt.shpron.ne Ministrine e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

SË SHPEJTI NË BOTIM:
INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Doli nga shtypi më 21.5.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë